



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PAVARUR I KUALIFIKIMIT

Nr. 217Akti

Nr. 259 Vendimi
Tiranë, më 15.6.2020

V E N D I M

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, i përbërë nga:

Xhensila Pine	Kryesuese
Brunilda Bekteshi	Relatore
Olsi Komici	Anëtar

asistuar nga sekretarja gjyqësore, znj. Denisa Kosta, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, znj. Elka Ermenkova, në datën 05.06.2020, ora 10:30, në Pallatin e Koncerteve, (ish-Pallati i Kongreseve), salla B, kati 0 (*underground*), Tiranë, mori në shqyrtim në seancë dëgjimore publike çështjen që i përket:

SUBJEKTI I RIVLERËSIMIT: **Znj. Bernina Kondi**, me detyrë gjyqtare në Gjykatën Administrative të Apelit Tiranë, përfaqësuar personalisht.

OBJEKTI: **Rivlerësimi kalimtar i subjektit të rivlerësimit.**

BAZA LIGJORE: **Neni 179/b, paragrafi 5, neni Ç, paragrafi 1 dhe nenet D, DH dhe E të Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë**, miratuar me ligjin nr. 76/2016, datë 22.7.2016, “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8417, datë 21.10.1998;

Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, e ndryshuar;

Ligji nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”;

Ligji nr. 49/2012, “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”.

TRUPI GJYKUES I KOMISIONIT TË PAVARUR TË KUALIFIKIMIT,

pasi dëgjoji arsyetimin ligjor dhe rekomandimin e relatores së çështjes, komisionere Brunilda Bekteshi, mori në shqyrtim dhe analizoi provat shkresore të paraqitura nga subjekti i rivlerësimit për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit kryesisht, si dhe shqyrtoi dhe analizoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

I. FAKTET DHE RRETHANAT E ÇËSHTJES

1. Subjekti i rivlerësimit, znj. Bernina Kondi, me detyrë gjyqtare në Gjykatën Administrative të Apelit Tiranë, referuar pikës 3, të nenit 179/b, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, i është nënshtruar rivlerësimit, *ex officio*, nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit (në vijim Komisioni).
2. Referuar neneve 33, 39 dhe 43, të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit janë administruar raportet e hartuara nga: Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave (në vijim ILDKPKI); Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar (në vijim DSIK) dhe Këshilli i Lartë Gjyqësor (në vijim KLGj).
3. Bazuar në pikën 2, të nenit 14, të ligjit nr. 84/2016 dhe në rregulloren “Për procedurat e zhvillimit të shortit”, Komisioni i Pavarur i Kualifikimit ka zhvilluar shortin në datën 15.3.2019, në përfundim të të cilit rezultoi që subjekti i rivlerësimit, znj. Bernina Kondi, do t’i nënshtruhej procesit të rivlerësimit nga trupi gjykues i përbërë nga komisionerët Xhensila Pine, Brunilda Bekteshi dhe Olsi Komici. Relatore e çështjes u zgjodh me short komisionere Brunilda Bekteshi.
4. Komisioni, me vendimin nr. 1, datë 21.11.2018, të trupit gjykues, vendosi të fillojë hetimin administrativ sipas nenit 45, të ligjit nr. 84/2016, me qëllim vlerësimin e të gjitha fakteve dhe rrethanave të nevojshme për procedurën e rivlerësimit të subjektit Bernina Kondi, si dhe caktoi kryesuesin e trupit gjykues, komisionere Xhensila Pine. Anëtarët e trupit gjykues deklaruan se nuk ishin në kushtet e konfliktit të interesit me subjektin e rivlerësimit.
5. Në datën 15.10.2019, subjektit iu komunikua në rrugë elektronike përbërja e trupit gjykues, duke iu bërë me dije e drejta për t’u shprehur në lidhje me konfliktin e interesit. Subjekti i rivlerësimit, në të njëjtën datë, deklaroi përmes postës elektronike se nuk ndodhej në kushtet e konfliktit të interesit.
6. Në datën 13.02.2020 Komisioni, me vendimin nr. 2, vendosi: (i) të përfundojë hetimin administrativ kryesisht për subjektin e rivlerësimit, znj. Bernina Kondi, vetëm për kriterin e pasurisë; (ii) të njoftojë subjektin e rivlerësimit mbi rezultatet e hetimit kryesisht, të paraqesë pretendimet e tij brenda 10 (dhjetë) ditëve nga marrja e njoftimit me postë elektronike për t’u njohur me provat e administruara nga Komisioni, në përputhje me nenin 47, të ligjit nr. 84/2016 dhe nenet 35 - 40 dhe 45 - 47 të Kodit të Procedurave Administrative.
7. Në datën 14.02.2020, subjektit të rivlerësimit iu njoftuan rezultatet e hetimit, për të cilat konfirmoi në datën 15.2.2020 marrjen dijani dhe në datën 23.2.2020, dërgoi brenda afatit të përcaktuar nga Komisioni: (i) kërkesën për t’u njohur me dosjen; (ii) shpjegimet për konkluzionet e hetimit dhe listën e provave të reja që do të paraqiste deri në datën 24.02.2020, në protokollin e Komisionit, në kuadër të paraqitjes së kërkesës së saj për riçelje të hetimit administrativ.
8. Trupi gjykues, mbi kërkesat e subjektit, pas analizimit të tyre, me anë të postës elektronike: (i) në datën 24.02.2020, informoi subjektin, se mbi disponimin e kopjes së dosjes, mund të paraqitej në çdo kohë, në Komision (ii) ka administruar të gjithë dokumentacionin e paraqitur nga ana saj; (iii) në datën 26.02.2020, referuar kërkesës për riçelje të hetimit dhe për dy kriteret e tjera, atë të pastërtisë së figurës dhe të aftësive profesionale, qartësoi subjektin se pas seancës dëgjimore dhe para marrjes së vendimit përfundimtar do të vlerësonte të gjitha provat dhe shpjegimet e dhëna dhe nëse ato do të çmoheshin bindëse dhe të mjaftueshme për rihapjen e

hetimit, atëherë trupi gjykues do të procedonte me marrjen e vendimit për rihapjen e hetimit edhe për dy kriteret e tjera; në vijim (iv) informoi se subjekti do të njoftohej për ditën dhe orën e mbajtjes se seancës dëgjimore.

9. Në datën 26.02.2020, trupi gjykues, me vendimin nr. 3, vendosi të ftojë subjektin e rivlerësimit, znj. Bernina Kondi në seancë dëgjimore, në përputhje me nenin 55, të ligjit nr. 84/2016. Subjekti u njoftua me anë të postës elektronike se seanca dëgjimore do të zhvillohej në datën 2.03.2020, në orën 14:00, në Pallatin e Koncerteve, Tiranë. Po ashtu, bëri me dije se pranoi të administronte shpjegimet dhe provat e dërguara nga subjekti pas dërgimit të rezultateve të hetimit dhe se mund të paraqiste çdo dokument të vlerësuar prej saj. Mbi këtë njoftim, subjekti i rivlerësimit konfirmoi me anë të postës elektronike, marrjen dijeni në të njëjtën datë.

10. Në datën 2.03.2020, subjekti i rivlerësimit paraqiti në Komision kërkesën për shtyrjen e seancës dëgjimore për arsye shëndetësore, provuar me raportin mjekësor të institutit shëndetësor nr. 9 dhe nr. regjistri (***), serial (***), datë 2.3.2020, për paafësi në punë deri më 16.3.2020. Pas shqyrtimit të kësaj kërkesë, trupi gjykues e pranoi dhe njoftoi subjektin për rifillimin e seancës dëgjimore në datën 18.3.2020, në orën 10:00.

11. Në referim të njoftimit publik të Komisionit¹, në kuadër të përshkallëzimit të masave mbrojtëse nga COVID-19, në datën 19.03.2020, Komisioni rikonfirmoi shtyrjen e seancës dëgjimore sipas njoftimit paraprak të bërë nga sekretaria gjyqësore në datën 15.03.2020, duke i komunikuar subjektit se mbi zhvillimin e seancës dëgjimore do të njoftohej në një njoftim të dytë.

12. Në zbatim të Aktit Normativ nr. 21, miratuar nga Këshilli i Ministrave datë 27.5.2020, i publikuar në fletoren zyrtare nr. 98, datë 29.5.2020, për disa ndryshime në Aktin Normativ nr. 9, datë 25.3.2020, “Për marrjen e masave të veçanta në fushën e veprimtarisë gjyqësore, gjatë kohëzgjatjes së gjendjes së epidemisë”, si dhe në vijim të komunikimeve elektronike datë 26 shkurt dhe 19 mars 2020, Komisioni bazuar në nenin 55 të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, si dhe Kodit të Procedurave Administrative, rinjoftoi subjektin në mënyrë elektronike se seanca dëgjimore do të zhvillohej në datën 5.06.2020, ora 10:30. Gjithashtu, Komisioni, në këtë njoftim i ka rikujtuar subjektit se njohja mbi të drejtat e saj i është bërë prezent në komunikimin elektronik datë 26.02.2020 ora 4:50.

II. SEANCA DËGJIMORE

13. Seanca dëgjimore me subjektin e rivlerësimit, znj. Bernina Kondi, u zhvillua në përputhje me kërkesat e nenit 55, të ligjit nr. 84/2016, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, znj. Elka Ermenkova. Subjekti i rivlerësimit ishte prezent në seancën dëgjimore, ku shpjegoi lidhur me rezultatet e hetimit dhe barrën e provës. Në përfundim të seancës dëgjimore, subjekti i rivlerësimit kërkoi që të riçeket hetimi administrativ, të vlerësohen dy kriteret e tjera, si dhe të rivlerësohet kriteri i pasurisë mbi bazën e provave dhe rezultateve që kanë sjellë provat e

¹Në kuadër të përshkallëzimit të masave mbrojtëse nga COVID-19, Komisioni i Pavarur i Kualifikimit njofton kufizimin e mëtejshëm të veprimtarisë institucionale dhe dërgimin e punonjësve në shtëpi deri në një njoftim të dytë zyrtar. Duke filluar nga data 13 mars 2020, veprimtaria e Komisionit të Pavarur të Kualifikimit do të vazhdojë të kryhet në ato funksione/detyra/njësi organizative që mund ta përmbushin në kushtet e banesës, nëpërmjet komunikimit elektronik dhe telefonik zyrtar. Gjithashtu, duke filluar nga data 13 mars 2020, pezullohen afatet për të gjitha vendimet dhe seancat dëgjimore për subjektet e rivlerësimit të publikuara për t'u zhvilluar, do të shtyhen deri në një njoftim të dytë zyrtar.

paraqitura prej tij për këtë kriter. Trupi gjykues, pasi dëgjoi subjektin në seancën dëgjimore publike të datës 05.06.2020, në Pallatin e Koncerteve, vlerësoi shpjegimet dhe dokumentacionin e paraqitur prej saj dhe në vijim të rezultateve të hetimit, arriti në përfundimin se provat e administruara gjatë hetimit administrativ nga Komisioni, për kriterin e pasurisë, kishin nivelin e provueshmërisë dhe subjekti nuk arriti të provojë të kundërtën e barrës së provës për disa prej tyre. Trupi gjykues, referuar parashikimeve të pikës 2, të nenit 4, të ligjit nr. 84/2016, si dhe pikës 16, të seksionit III, të Vendimit nr. 3, datë 17.7.2018, të Kolegjit të Posaçëm të Apelit, vlerëson se, kur provat kanë nivelin e provueshmërisë, vendimi mund të merret bazuar vetëm në atë kriter vlerësimi. Vendimi mbi përfundimin e procesit të rivlerësimit për subjektin e rivlerësimit, znj. Bernina Kondi, vetëm mbi kriterin e vlerësimit të pasurisë, nuk përbën në asnjë rast gjë të gjykuar për kriterin e figurës dhe atë të vlerësimit profesional. Trupi gjykues, rifilloi seancën dëgjimore për shpalljen e vendimit, në datën 15.06.2020.

III. QËNDRIMI DHE MENDIMI I SUBJEKTIT TË RIVLERËSIMIT

Znj. Bernina Kondi ka qenë bashkëpunuese në procesin e rivlerësimit të kryer ndaj saj, duke u përgjigjur kur është kërkuar, sipas afatit të përcaktuar, sipas nenit 48, të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, gjatë gjithë procedurës së hetimit administrativ të zhvilluar ndaj saj.

1. Vlerësimi i pasurisë nga ILDKPKI-ja

ILDKPKI ka dërguar një raport të hollësishëm dhe të arsyetuar për dosjen nr. IND (***), me shkresën nr. (***), datë 31.5.2018, në përputhje me nenin 33, të ligjit nr. 84/2016, si për subjektin e rivlerësimit, ashtu edhe për personin e lidhur për vlerësimin e pasurisë së subjektit të rivlerësimit, sipas neneve 30 – 33, të ligjit nr. 84/2016, ku konstatohet: (i) deklarimi nuk është i saktë në përputhje me ligjin, ka veprime fiktive dhe mashtrim për përfitime të padrejta; (ii) nuk ka burime financiare të ligjshme; (iii) ka kryer fshehje të pasurisë ndër vite; (iv) ka kryer deklarim të rremë; (v) subjekti nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesave. Nga verifikimi i datës së dorëzimit të deklaratës së pasurisë “Vetting”, në zbatim të nenit 31/11, rezulton se subjekti i rivlerësimit, znj. Bernina Kondi, e ka dorëzuar deklaratën e pasurisë në datën 26.01.2017 (duke përfshirë personin e lidhur), në bazë të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, dhe ky fakt konfirmohet nga ILDKPKI-ja nëpërmjet vërtetimit të lëshuar. Për sa më sipër, subjekti e ka dorëzuar deklaratën e pasurisë në periudhën kur ligji ka qenë në fuqi dhe brenda afatit 30-ditor nga hyrja e tij në fuqi. Gjithashtu, në referencë të nenit 32/2, të ligjit nr. 84/2016 dhe në zbatim të ligjit nr. 9049, datë 10.4.2003, “Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë”, i ndryshuar, dhe të ligjit nr. 9367, datë 10.4.2005, “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”, i ndryshuar, vërehet se subjekti i rivlerësimit, znj. Bernina Kondi, është bërë subjekt deklarues në ILDKPKI në vitin 2003.

IV. PROCESI I RIVLERËSIMIT/HETIMI I KRYER NGA KOMISIONI I PAVARUR I KUALIFIKIMIT

Bazuar në nenet 45, 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016, Komisioni, kreu hetim dhe vlerësim të të gjitha fakteve dhe rrethanave të nevojshme për procedurën e rivlerësimit, duke marrë në analizë: (a) provat e dorëzuara nga subjekti në ILDKPKI, në deklaratën e pasurisë për rivlerësimin kalimtar, “Vetting”; (b) raportin e dorëzuar në Komision nga ILDKPKI-ja; (c) provat shkresore/dokumentet e administruara nga organet publike dhe private, në përputhje me nenet 49 dhe 50, të ligjit nr. 84/2016; (ç) deklaratimet e subjektit të rivlerësimit me anë të komunikimit elektronik; (d) shpjegimet me shkrim të subjektit të rivlerësimit, datë 24.2.2020

dhe deklarimeve të subjektit gjatë seancës dëgjimore, për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit; (e) deklaratimet e bëra nga subjekti i rivlerësimit në ILDKPKI; (ë) analizën financiare të bërë nga Njësia Ligjore e Komisionit të Pavarur të Kualifikimit.

Nga shqyrtimi i provave të administruara nga Komisioni, për secilën nga pasuritë dhe të ardhurat e deklaruara nga subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur rezulton, si vijon:

KRITERI I PASURISË

Mbi pasuritë e deklaruara në deklaratën “Vetting”, sipas formularit (shtojca nr. 2), të datës 26.1.2017, nga subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur me të, në zbatim të ligjit nr. 84/2016, nga hetimi ka rezultuar, si vijon:

1. Në lidhje me apartament banimi me sip. 57 m², kati IV, me vendndodhje Rr. “(****)”, Tiranë, ndërtuar nga shoqëria “B. N.” sh.p.k., përfituar me kontratë sipërmarrjeje datë 21.9.2004, i përfunduar në maj të vitit 2006. Vlera totale e apartamentit: 39.000 euro. Pjesa takuese: 100 %. Burimi i deklaruar i krijimit: kredia e marrë në “Alpha Bank” datë 7.7.2005, në vlerën 2.500.000 lekë; kredi e marrë në fondacionin Besa, datë 18.7.2006, në vlerën 500.000 lekë; të ardhura që dispononte familja e subjektit, si dhe të ardhura të mbledhura nga shitja e librave të botuara prej saj. Subjekti i ka bashkëlidhur deklaratës disa dokumente².

1.1 ILDKPKI-ja, në raportin e saj, ka konstatuar se subjekti nuk ka paraqitur dokumentacion të plotë justifikues ligjor lidhur me shlyerjet e kësteve për blerjen e apartamentit në shumën 39.000 euro, gjithashtu, në deklaratat e interesave private ndër vite nuk ka deklaruar shlyerjen e këstit të fundit. Subjekti, në deklaratën e interesave private të vitit 2004, ka deklaruar të ardhura nga botimi i librave në shumën 1.000.000 lekë, për vërtetimin e të cilave mungon dokumentacioni justifikues ligjor, çka e bën deklarinimin e rremë.

Faktet e rezultuara gjatë hetimit administrativ

1.2 Nga korrespondenca e mbajtur me ASHK-në, Drejtorinë Vendore Tiranë Rurale³ 2, Drejtorinë Vendore Tiranë Rurale⁴ 1, Drejtorinë Vendore Tiranë Veri⁵, Drejtorinë Vendore Tiranë Jug⁶, nuk konfirmojnë ekzistencën e kësaj pasurie.

1.3 Komisionit nga verifikimi i deklaratave periodike vjetore i ka rezultuar se subjekti e deklaron për herë të parë këtë pasuri:

1.3.a në deklaratën periodike vjetore të vitit 2004, me përshkrimin “kontratë sipërmarrje e datës 21.9.2004, për ndërtimin e një apartamenti”. Pagesë kësti i parë në shumën 12.000 euro nga të ardhurat e përgjithshme të familjes dhe nga shitja e librave. Vlera totale: 39.000 euro; ndërsa,

1.3.b në deklaratën periodike vjetore të vitit 2005 deklaron se është paguar gjatë vitit 2005, sipas kontratës, shuma 23.000 euro, me kredinë e marrë.

1.4 Kjo pasuri konfirmohet me kontratën e sipërmarrjes⁷, datë 21.9.2004, me palë sipërmarrëse shoqërinë “B. N.” sh.p.k., dhe palë porositëse shtetasen Bernina Kondi. Sipas kontratës, apartamenti përshkruhet me sip. 57 m² dhe çmimi përcaktohet në vlerën 39.000 euro.

²Kontratë sipërmarrjeje nr. (***), datë 21.9.2004; kontratë kredie në “Alpha Bank” nr. (***), datë 28.6.2005; shtesë kontratës së kredisë me “Alpha Bank” nr(***), datë 28.6.2005; marrëveshje shtese financimi me “Alpha Bank”, (***), datë 28.6.2005; kontratë hipoteke me “Alpha Bank” nr. (***), datë 28.6.2005; mandatpagese nr. (***), datë 24.7.2006 (Aneksi nr. 4/2, në dosjen e ILDKPKI-së).

³ Referojuni shkresës nr. (***), prot., datë 8.11.2019, në dosjen e Komisionit.

⁴ Referojuni shkresës nr. (***), prot., datë 8.11.2019, në dosjen e Komisionit.

⁵ Referojuni shkresës nr. (***), prot., datë 11.11.2019, në dosjen e Komisionit.

⁶ Referojuni shkresës nr. (***), prot., datë 11.11.2019, në dosjen e Komisionit.

⁷ Aneksi 4/2, në dosjen e ILDKPKI-së.

1.4.a Në këtë kontratë parashikohet se vlera e apartamentit do të likuidohet sipas mënyrës së mëposhtme:

- në momentin e lidhjes së kontratës do t'i likuidohet sipërmarrësit vlera prej 12.000 euro;
- kësti i dytë në vlerën prej 11.000 euro, do të likuidohet brenda shkurtit të vitit 2005;
- shuma prej 12.000 euro do të likuidohet brenda nëntorit të vitit 2005;
- diferenca tjetër e çmimit prej 4.000 euro do të likuidohet në momentin e dorëzimit të çelësave të apartamentit.

1.5 Nga korrespondenca e mbajtur me OSHEE-në⁸ konfirmohet një abonent me kontratë furnizimi nr(***), në emër të znj. Bernina Kondi, në adresën: rruga “(***)”, kabina B. N. .

1.6 Nga korrespondenca e mbajtur me UKT-në⁹ konfirmohet kontrata nr. (***), në emër të znj. Bernina B. Kondi, me status aktiv në rrugën “(***)”, Tiranë.

1.7 Komisioni ka pyetur¹⁰ subjektin për mënyrën e likuidimit të kësaj pasurie, për të cilën ka depozituar tri mandate me të dhënat, si më poshtë:

Tabela nr. 1

Nr.	Data	Vlera	Monedha
40	21.09.2004	12,000	euro
83	25.07.2005	23,000	euro
98	20.07.2006	4,000	euro
		39,000	

1.7.i Nga administrimi i mandateve, Komisioni ka konstatuar ekzistencën e mandatit që pasqyron shumën 4.000 euro, të paguar si këst i fundit për këtë pasuri, sipas parashikimit kontraktor, pagesë të cilën subjekti nuk e ka deklaruar në deklaratën “Vetting” dhe as në deklaratën për vitin 2006.

1.7.ii Gjithashtu, gjatë hetimit ka rezultuar¹¹ se subjekti ka depozituar përtej tri mandateve që konfirmojnë shumën prej 39.000 euro edhe një mandat tjetër nr. (***), datë 24.7.2006, në shumën 8.000 euro për shoqërinë “B. N.” me përshkrimin “pagesë shtëpisë ap. 1+1, kësti i fundit”.

1.7.ii.a Nga verifikimi i kryer, Komisioni ka konstatuar se subjekti nuk e ka deklaruar në deklaratën “Vetting” dhe as në deklaratën për vitin 2006, pagesën e shumës 8.000 euro me përshkrimin “pagesë shtëpisë ap.1+1, kësti i fundit”.

1.8 Në ndryshim nga përshkrimi i bërë në mandatin nr. (***), datë 24.7.2006, tri mandatet e pasqyruara në tabelën nr. 1, nuk pasqyrojnë përshkrim të qëllimit të arkëtimit të shumave.

1.8.i Komisioni ka pyetur¹² subjektin mbi këtë konstatim (pra, në lidhje me pagesën e shumës 8.000 euro), nga ku ka deklaruar: *“Pas pagimit të këstit të dytë, një nga pjesëtarët e familjes sime, gjyshja, pati një problem të rëndë shëndetësor, i cili kërkonte kurim të shpejtë jashtë vendit dhe një shpenzim monetar të cilin prindërit e mi për momentin nuk e përballonin dot. Për këtë arsye, pas kërkesës së babait tim, unë kam folur verbalisht me përfaqësuesin e firmës së ndërtimit ‘B.N.’ për të më kthyer dorazi nga vlera e këstit të dytë të paguar prej 23.000 euro, një shumë prej 8.000 (tetë) euro, që do e përdornim për këtë rast shëndetësor urgjent. Për këtë*

⁸ Me shkresën nr. (***)prot., datë 29.10.2019.

⁹ Me shkresën K-(***) prot., datë 25.10.2019.

¹⁰ Pyetësor nr. 2, datë 16.12.2019.

¹¹ Aneks 4/2 në dosjen e ILDKPKI-së.

¹² Pyetësor nr.3, datë 7.1.2020.

*veprim ju paraqes mandatpagesën përkatëse nr. (***) datë 23.5.2006, lëshuar nga përfaqësuesi i firmës që provon kthimin e shumës prej 8.000 euro. Si pasojë e këtij veprimi, kësti i dytë mbeti i shlyer në vlerën 15.000 (pesëmbëdhjetë) euro. Pas pagimit të këstit të tretë unë i detyrohesha firmës nga shuma totale 39.000 euro e apartamentit sipas kontratës së sipërmarrjes, shumën prej 8.000 euro, e cila i është paguar firmës sipas mandatarkëtimit nr. (***), të datës 24.7.2006. Kjo shumë prej 8.000 euro më është kthyer mua nga babai im, pasi gjendja e gjyshes sime u stabilizua pas trajtimit mjekësor në Shqipëri dhe nuk u përdor për kurimin e saj jashtë vendit. Pra, mandati i datës 24.7.2006 mbyll detyrimet e mia ndaj shoqërisë së ndërtimit, duke u likuiduar vlera totale prej 39.000 euro për apartamentin në fjalë.”*

1.9 Subjekti ka depozituar mandatpagesën nr. (***), datë 23.5.2006, në shumën 8.000 euro, me përshkrimin “zvogëlim të pagesës së këstit të paguar më parë”, si dhe deklaratën noteriale nr. (***), datë 10.1.2020, të shoqërisë “B. N.” sh.p.k., nënshkruar nga shtetasi J. C., si përfaqësues i shoqërisë.

1.10 Komisioni i kërkoi edhe ILDKPKI-së çdo dokumentacion apo korrespondencë të mbajtur me subjektin ndër vite, në kuadër të kontrollit të subjekteve pranë këtij institucioni.

1.11 Nga verifikimi i dokumentacionit të përcjellë, Komisionit i rezultoi se në procesverbalin¹³ e mbajtur në ILDKPKI datë 6.3.2012, subjekti ishte pyetur nëse dispononte fatura për likuidimin e kësteve të kësaj kontrate sipërmarrjeje dhe u vërejt se kishte deklaruar disponimin vetëm të mandatarkëtimit nr. (***), datë 24.7.2006, të pagesës së këstit të fundit prej 8.000 euro (depozituar edhe në dosjen e ILDKPKI-së me deklaratën “Vetting”) dhe jo tri mandatet e depozituara përgjatë hetimit administrativ të Komisionit. Nga aktet e administruara në dosjen e ILDKPKI-së ka rezultuar se këto mandate nuk janë depozituar as me deklaratën për “Vetting”. Po ashtu, ka rezultuar se nga subjekti në deklaratën “Vetting” nuk është depozituar as mandati i tërheqjes dhe kthimit (për arsytet e lartpërmendura) të shumës 8.000 euro në vitin 2006, për llogari të shoqërisë sipërmarrëse ndërtimore.

1.11.i Komisioni ka konstatuar se kur është pyetur subjekti në datën 6.3.2012 nga ILDKPKI-ja, nuk ka deklaruar zvogëlimin e shumës 23.000 euro, të paguar në vitin 2005 në favor të shoqërisë ndërtimore, si dhe nuk ka depozituar në këtë institucion asnjë prej mandateve të depozituara me pyetësorët e bërë gjatë hetimit administrativ nga Komisioni.

1.12 Në lidhje me burimin e krijimit të kësaj pasurie, subjekti ka deklaruar në deklaratën për “Vetting”:

- a) kredi të marrë në “Alpha Bank”, në datën 7.7.2005, në vlerën 2.500.000 lekë;
- b) kredi e marrë nga fondacioni Besa, në datën 18.7.2006, në shumën 500.000 lekë,
- c) të ardhura nga familja; si dhe
- d) të ardhura të mbledhura nga shitja e librave të botuara prej saj.

1.13 Komisioni hetoi mbi çdo burim krijimi të kësaj pasurie, për të verifikuar ligjshmërinë e tyre, si dhe mundësinë financiare të subjektit.

a) Në lidhje me kredinë e marrë në “Alpha Bank” në datën 7.7.2005, në vlerën 2.500.000 lekë Nga aktet e administruara, kjo kredi konfirmohet me:

- kontratën e kredisë¹⁴ shërbyer me llogari rrjedhëse nr. (***), datë 28.6.2005, në “Alpha Bank”, nr. (***), datë 28.6.2005, në shumën 2.500.000 lekë;
- shtesën e kontratës së kredisë së shërbyer me llogari rrjedhëse nr. (***), datë 28.6.2005, në “Alpha Bank”, nr. (***), datë 28.6.2005. Shtetasit Th. T. dhe B. N.(T.) kanë

¹³ Shkresë nr. (***) prot., datë 10.1.2020, nga ILDKPKI-ja.

¹⁴ Aneks 4/2, në dosjen e ILDKPKI-së.

hipotekuar/bllokuar pronën në favor të bankës për kontratën e kredisë me kredimarrëse znj. Bernina Kondi;

- marrëveshjen shtesë të financimit nr. (***) , datë 28.6.2005;
- kontratën e hipotekimit nr. (***) , datë 28.6.2005, ku hipotekohet në favor të bankës, pasuria e paluajtshme me vendndodhje në Berat, nr. (***) , vol. (***) , f. (***) , z. k. (***) .

Në lidhje me këtë kredi, “Alpha Bank” ka konfirmuar në mënyrë elektronike¹⁵, por edhe shkresore¹⁶ *disbursimin* e saj në favor të subjektit të rivlerësimit, datë 7.7.2005, në shumën 2.500.000 lekë. Nga dokumentacioni i përcjellë, Komisioni ka konstatuar se nga llogaria e kredisë, subjekti ka kryer dy transaksione, përkatësisht, datë 7.7.2005, në shumën 1.230.000 lekë dhe në datën 13.7.2005, po në shumën 1.230.000 lekë, por nuk identifikohet përshkrimi i këtyre transfertave dhe as përfituesi i tyre.

b) Në lidhje me kredinë e marrë nga Fondi Besa, në datën 18.7.2006, në shumën 500.000 lekë Fondi Besa, me shkresën nr. (***)prot., datë 30.10.2019, konfirmon se shtetasja Bernina Kondi ka marrë kredi në këtë fondacion në datën 17.7.2006, shumën prej 500.000 lekësh me afat 24 muaj, detyrim ky i cili është mbyllur.

Sipas mandateve të depozituara nga subjekti duket se kësti i datës 20.7.2006 është paguar me këtë kredi.

c) Në lidhje me të ardhurat nga familja

Komisioni e ka pyetur¹⁷ subjektin se sa ka qenë kontributi i prindërve për blerjen e kësaj pasurie dhe burimin e ligjshëm të këtyre të ardhurave. Subjekti ka deklaruar se: *“Kontributi i prindërve të mi ka qenë përafërsisht 750.000 lekë dhe se këto të ardhura janë siguruar gjatë gjithë jetës nga prindërit e mi nga paga e tyre ndër vite, nga shuma që babai im ka përfituar nga ekzekutimi i vendimit gjyqësor për lirimin e padrejtë nga shërbimi civil, si dhe nga të ardhurat e realizuara nga produktet bujqësore të realizuara nga sipërfaqja e tokës e përfituar nga ligji nr.7501/1991”*

- ✓ Komisionit, nga analizimi i dokumentacionit të depozituar, i ka rezultuar se duket se prindërit e subjektit me të ardhurat nga punësimi në vitet 1994 – 2004, kanë pasur mundësi financiare të përballojnë shumën prej 750.000 lekësh.

d) Në lidhje me të ardhurat e mbledhura nga shitja e librave të botuar

Subjekti ka deklaruar në deklaratën periodike vjetore të vitit 2004 të ardhura nga botimet në shumën 1.000.000 lekë.

Komisioni e ka pyetur¹⁸ subjektin për këto të ardhura dhe për burimin e ligjshëm të tyre, për të cilat subjekti ka depozituar kontratë bashkëpunimi për datat 9.1.2002 dhe 3.2.2003, si dhe 25 mandatpagesa për të ardhurat nga botimet e dy librave. Nga këto mandate rezulton se subjekti ka përfituar shumën 999.000 lekë, ndërsa në lidhje me pagesat e detyrimeve tatimore ka deklaruar se: *“Subjekti botues i kontraktuar në cilësinë e sipërmarrësit, në të njëjtën kohë edhe subjekt financues i këtyre botimeve, ka përlllogaritur në mënyrë të detajuar koston e plotë të secilit prej botimeve, përfshirë dhe të gjitha taksat në këtë përlllogaritje, duke përcaktuar shumën prej 25 % të vlerës totale të arkëtuar nga shitja e secilit prej teksteve dhe ka marrë përsipër për të përlllogaritur dhe paguar në përputhje me dispozitat detyruese të legjislacionit tatimor”*.

¹⁵ Shihni e-mail, datë 12.2.2020, në dosjen e Komisionit.

¹⁶ Shkresë nr. (***) prot., datë 12.2.2020.

¹⁷ Pyetësori nr. 3, datë 7.1.2020.

¹⁸ Pyetësori nr. 2, datë 16.12.2019 dhe pyetësori nr. 3, datë 7.1.2020.

Ndërsa në procesverbalin¹⁹ e mbajtur në ILDKPKI datë 6.3.2012, subjekti është pyetur nëse dispononte ndonjë vërtetim apo faturë që vërteton të ardhurat e realizuara nga shitja e librave, nga ku ka deklaruar se në lidhje me të ardhurat e realizuara nga shitja e librave nuk ka fatura, pasi këto libra janë shitur në librari të ndryshme dhe në sasi të ndryshme. Komisioni, në analizim të deklaramëve të subjektit dhe dokumentacionit të depozituar, konstaton se nuk provohen me dokumentacion justifikues ligjor pagesat e detyrimeve tatimore mbi këto të ardhura të përfituara gjatë viteve 2002 – 2004.

1.14 Pas analizimit të të gjitha burimeve për krijimin e kësaj pasurie, Njësia e Shërbimit Ligjor kreu analizën financiare për vitet 2004 – 2006, vite kur janë kryer pagesat për blerjen e këtij apartamenti, duke mos marrë në konsideratë të ardhurat nga botimet e librave (për këtë të fundit shihni më sipër arsyetimin e bërë në germën “d”).

Tabela nr. 2

Nr.	Përshkrimi	2004	2005	2006
1	TË ARDHURA	1,544,548	858,020	931,810
	Të ardhura nga paga subjekti	794,548	858,020	931,810
	Të ardhura nga prindërit	750,000	-	-
2	SHPENZIME	(3,328,116)	557,226	582,832
	Shpenzime jetese sipas ILDKPKI-së	93,864	109,557	109,557
	Shpenzime kredia në “Alpha Bank”		36,782	
	Detyrim financiar për ap. me sip. 57 m ²	(3,421,980)	2,818,420	494,812
	Kredi në “Alpha Bank” (7.7.2005) (2.500.000 lekë)	-	(2,407,544)	375,463
	Kredi te Fondi Besa (18.7.2006) (500.000 lekë)	-	-	(397,000)
3	PASURI	4,966,817	210,460	(25,766)
	Pasuri e paluajtshme/e luajtshme			
	Kontratë sipërmarrjeje për ndërtim ap. me sip. 57 m ² (21.9.2004)	4,942,860	-	
	Automjet tip “Opel Corsa”	-	200,000	-
	<i>Ndryshim likuiditeti</i>	23,957	10,460	(25,766)
	DIFERENCA (1-2-3)	-94,153	90,335	374,741

1.15 Për të gjitha faktet e sipërpërmendura, për të qartësuar çdo situatë në lidhje me mungesën e dokumentacionit që provonte transaksionet dhe destinacionin e kredive, apo edhe për të provuar të kundërtën mbi faktet e dala nga hetimi dhe konstatimet e analizuara, si më poshtë referohet, Komisioni i kaloi subjektit barrën e provës²⁰, si dhe kërkoi dhënien e shpjegimeve pasi:

- (i) dukej se subjekti nuk kishte pasur mundësi financiare në shumën 94.153 lekë²¹ për të investuar në blerjen e pasurisë apartament banimi me sip. 57 m², si dhe për të përballuar shpenzimet e tjera familjare;
- (ii) mungonte dokumentacioni justifikues për të provuar burimin e ligjshëm të të ardhurave nga botimet e librave;
- (iii) mungonte dokumentacioni justifikues bankar mbi destinacionin e dy transaksioneve të kryera në llogarinë e kredisë në “Alpha Bank”, në datën 7.7.2005, në shumën 1.230.000 lekë

¹⁹ Shkresë nr. (***)prot., datë 10.1.2020, nga ILDKPKI-ja.

²⁰ Bazuar në nenin 52, të ligjit nr. 84/2016, dhe paragrafët 3 dhe 5, të nenit D, të Aneksit të Kushtetutës.

²¹ Ky rezultat është deri aktualisht dhe mund të ndryshojë në varësi të shpjegimeve dhe dokumentacionit provues të depozituar nga subjekti i rivlerësimit.

dhe në datën 13.7.2005, po në shumën 1.230.000 lekë, si dhe dokumentacioni justifikues bankar mbi tërheqjen e kredisë në shumën prej 2.500.000 lekësh në po këtë bankë;

(iv) rezultuan mospërputhje të deklarimeve të subjektit në deklaratën periodike vjetore për vitin 2006, ku nuk deklarohet kësti i fundit në shumën 4.000 euro sipas parashikimit kontraktor; zvogëlimi në vitin 2006 me 8.000 euro i shumës (23.000 euro) së paguar në vitin 2005; kthimi i kësaj shume në vitin 2006, me deklarimin e subjektit në ILDKPKI në datën 6.3.2012, se dispononte vetëm mandatarkëtimin nr. (***) datë 24.7.2006 të pagesës së kështit të fundit prej 8.000 euro, me mosdeklarimin e kryerjes së këtyre veprimeve financiare në deklaratën “Vetting”, si dhe me deklarimet dhe dokumentacionin e depozituar përgjatë hetimit administrativ nga Komisioni në lidhje me pagesat e kësaj pasurie;

(v) mosdeklarimi nga subjekti në deklaratën periodike të vitit 2006, të shumës 4.000 euro, si këst i fundit i kësaj pasurie, sipas parashikimit kontraktor dhe shumës 8.000 euro, në po këtë deklaratë si *këst i fundit* sipas përshkrimit në mandat, bën të paqartë vlerën e paguar për këtë pasuri;

(vi) rezultuan mospërputhje midis deklarimit dhe dokumentacionit të depozituar nga subjekti gjatë hetimit administrativ nga Komisioni, në lidhje me provueshmërinë e të ardhurave nga shitja e librave të botuar me deklarimin e dhënë në ILDKPKI në datën 6.3.2012, se në lidhje me të ardhurat e realizuara nga shitja e librave nuk ka fatura, pasi këto libra janë shitur në librari të ndryshme dhe në sasi të ndryshme.

Qëndrimi i subjektit në lidhje me faktet e konstatuara nga Komisioni

1.16 Lidhur me mungesën e aftësive financiare për blerjen e kësaj pasurie, nisur nga vlera e kësaj difference, paraprakisht subjekti ka referuar disa vendime²² të paankimuara të Komisionit, në të cilat janë bërë vlerësime mbi bazën e parimit të proporcionalitetit, duke i konsideruar si pasaktësi që nuk kanë ndikuar në vlerësimin tërësor të pasurisë së subjekteve të vlerësuara, apo vlerësuar si jo të mjaftueshme për aplikimin e një mase disiplinore. Po ashtu, lidhur me pagesat e detyrimeve tatimore ka referuar sërish vendime²³ të Komisionit të paankimuara, të vlerësuara me “bindjen e brendshme” për deklarime të subjekteve, bindëse dhe të mjaftueshme.

1.16.i Subjekti ka parashtruar se Komisioni duhet të ketë në konsideratë standardet²⁴ e vendosura në procesin e rivlerësimit, për ekzistencën ose jo të lidhjes shkakësore midis mosdeklarimit të likuiditeteve dhe pasojës që ka ardhur nga ky mosdeklarim, qëllimit/dashjes në mosveprimin e subjekteve rivlerësues. Sipas subjektit, nuk gjendet e arsyetuar lidhja shkakësore, qëllimi apo dashja e saj, si dhe fakti nëse pasuritë që pretendohen se janë të padeklaruara, vijnë nga burime të ligjshme apo të paligjshme, duke treguar një situatë paligjshmërie që cenon procesin e hetimit administrativ si dhe të drejtat e saj. Sipas subjektit, Komisioni ka konsideruar në disa vendime²⁵ pakujdesi në plotësimin e deklaratave, madje edhe në raste kur subjekti nuk kishte deklaruar as pasuritë. Në vijim ka parashtruar një analizë juridike²⁶ të dispozitave ligjore “Për rivlerësimin e gjyqtarëve dhe prokurorëve”, mbi rastet e aplikimit të masave disiplinore.

1.16.ii Në lidhje me burimin e ligjshëm të kësaj pasurie dhe deklarimet në raport me gjetjet e Komisionit, subjekti ka parashtruar se ka deklaruar fillimisht këtë pasuri në deklaratën periodike të vitit 2004, me përshkrimin “kontratë sipërmarrjeje e datës 21.9.2004 për ndërtimin e një apartamenti”, duke deklaruar edhe pagimin e kështit të parë sipas mënyrës që ishte përcaktuar në kontratën e sipërmarrjes, e provuar me mandatpagesën nr. (***) datë 21.9.2004.

²²Vendimi nr. 91, datë 20.12.2018; vendimi nr.153, datë 7.6.2019; vendimi nr.188, datë 24.7.2019.

²³Vendimi nr. 20, datë 4.6.2018.

²⁴ Standard që sipas subjektit referohet në vendimin nr. 49, datë 25.7.2018 të Komisionit.

²⁵ Subjekti ka referuar vendimet e Komisionit si: vendimin nr.16, datë 30.5.2018 ;vendimin nr.76, datë 12.11.2018;vendimin nr.13, datë 5.4.2018 ; vendimin nr. 105, datë 12.2.2019; vendimin nr. 49, datë 25.7.2018; vendimin nr.181, datë 18.7.2019.

²⁶ Referoju parashtrimeve të subjektit datë 24.2.2020.

Në deklaratën periodike të vitit 2005 kishte deklaruar, sipas kontratës, këstin e dytë në shumën prej 23.000 euro, shumë kjo e marrë nga kredia në “Alpha Bank”. Gjithashtu, subjekti ka parashtruar se pavarësisht parashikimeve²⁷ në kontratë, ka paguar dy shumat 11.000 +12.000 euro =23.000 euro në një pagesë të vetme, pasi u *disbursua* kredia.

1.16.iii Në vijim, lidhur me pagesat sipas mandateve të administruara, subjekti ka shpjeguar se sipas përcaktimeve në kontratë, pagesa e fundit për blerjen e këtij apartamenti ishte në vlerën 4.000 euro, pagesë e cila ishte kryer, referuar mandatin nr. (***), datë 20.7.2006 dhe mosdeklarimi i saj në deklaratën “Vetting” dhe në deklaratën e vitit 2006 ka qenë një pasaktësi e saj dhe kursesi një fshehje, pasi e kishte deklaruar këtë pagesë që duhet të kryente që në momentin e parë kur kishte deklaruar kontratën e sipërmarrjes, por realisht kësti i fundit që ishte paguar kishte qenë shuma prej 8000 euro, sipas mandatin nr. (***), datë 24.7.2006, me përshkrimin “pagesë shtëpisë ap.1+1, kësti i fundit”, përshkrim ky që kishte pasur si qëllim evidentimin e shumës së saktë të pagesës totale të apartamentit prej 39.000 euro.

1.16.iv Lidhur me faktet e konstatuara nga Komisioni se mandati nr. (***), datë 24.7.2006, në vlerën 8.000 euro, përmbante përshkrimin e këstit të fundit dhe jo mandati nr. (***), datë 20.7.2006, me vlerë prej 4.000 euro, subjekti ka parashtruar të njëjtin sqarim si gjatë hetimit administrativ të lidhur me kthimin nga shoqëria ndërtuese të shumës 8.000 euro, si pjesë të këstit të dytë të paguar për shkak të problemit shëndetësor të gjyshes, duke e konsideruar këstin e dytë të paguar në shumën 15.000 euro, dhe jo në 23.000 euro sa ishte paguar, provuar me mandatpagesën përkatëse nr. (***), datë 23.5.2006, lëshuar nga përfaqësuesi i firmës që provonte kthimin e shumës prej 8.000 euro. Shuma 8.000 euro i ishte paguar firmës në datën 24.7.2006, sipas mandatar-këtimit nr. (***), pasi kjo shumë i ishte kthyer subjektit nga babai për shkak se gjendja e gjyshes ishte stabilizuar pas trajtimit mjekësor në Shqipëri dhe nuk ishte përdorur për kurim jashtë vendit.

1.16.v Lidhur me mosdeklarimin në deklaratën “Vetting” dhe as në deklaratën periodike të vitit 2006, të veprimeve të ndodhura për pagesën e kësteve, ndër të tjera, subjekti ka parashtruar se kjo kishte ndodhur pasi tërheqja e shumës prej 8.000 euro nga firma e ndërtimit në datën 23.5.2006 dhe ripagimi i saj në datën 24.7.2006, kishin ndodhur si veprime brenda të njëjtit vit financiar. Për të provuar arsyet e gjendjes shëndetësore të gjyshes, të parashtruara në pikën 1.8.i, subjekti ka paraqitur si provë të re shkresën nr(***).prot., datë 20.2.2020, lëshuar nga drejtoria e spitalit rajonal Berat dhe kopje të regjistrit të urgjencës të njehsuar me origjinalin.

1.16.vi Në lidhje me konstatimin e Komisionit se mandatet ishin dorëzuar vetëm gjatë hetimit administrativ, ndër të tjera²⁸, subjekti ka sqaruar se në kohën kur është lidhur kontrata e sipërmarrjes dhe ka filluar likuidimi i kësteve kishte pasur bindjen se e rëndësishme ishte pagimi i vlerës *de facto* i apartamentit dhe jo ruajtja e këtyre mandateve, e cila ishte kryer *cash*, dhe jo me bankë, referuar praktikës së asaj kohe.

1.16.vii Mbi qëllimin e përdorimit të kredisë, subjekti ka parashtruar se nuk bie dakord me konstatimet e Komisionit, pasi të gjitha veprimet e saj, si dhe dokumentacioni i paraqitur tregon qartë që çdo veprim ka qenë në përputhje të plotë me realizimin e kontratës së sipërmarrjes, dhe se huaja, sipas parashikimeve të kontratës²⁹ së lidhur me shoqërinë bankare “Alpha Bank A. E.”, ishte lidhur me qëllimin e vetëm për blerje apartamenti. Shuma totale e kredisë prej

²⁷ Në momentin e lidhjes së kontratës do të likuidohet sipërmarrësit vlera prej 12.000 euro. Kësti i dytë prej 11.000 euro do të likuidohet brenda shkurtit të vitit 2005. Shuma prej 12.000 euro do të likuidohet brenda nëntorit të vitit 2005. Diferenca tjetër e çmimit prej 4.000 euro do të likuidohet në momentin e dorëzimit të çelësave të apartamentit.

²⁸ Referoju parashtrimeve të subjektit datë 24.2.2020.

²⁹ Neni 1 i kësaj kontrate; nenet e tjera, 2 e vijues, të parashtruar nga subjekti referohen në akte dhe parashtrimet e datës 24.2.2020

2.500.000 lekësh ishte tërhequr në dy këste, pasi banka nuk mund të lëvronte gjithë shumën e kredisë në një ditë dhe nga Komisioni ishte kuptuar gabim si veprim bankar, tërheqje të ndonjë shume tjetër, përveç shumës së kredisë. Subjekti ka depozituar edhe kontrata të ngjashme³⁰ të së njëjtën godinë për të provuar vlerën reale të paguar për blerjen e kësaj pasurie.

1.16.viii Lidhur me konstatimin e Komisionit se mungonte dokumentacioni justifikues për të provuar burimin e ligjshëm të të ardhurave nga botimet e librave, ndër të tjera, subjekti ka parashtruar se i kishte deklaruar rregullisht si burim, ka depozituar kontratë bashkëpunimi për datat 9.1.2002 dhe 3.2.2003, si dhe 25 mandatpagesa për të ardhurat nga botimet e dy librave, sipas të cilave kishte përfituar shumën 999.000 lekë.

1.16.ix Në lidhje me pagesën e detyrimeve tatimore për këto të ardhura, subjekti, ndër të tjera ka parashtruar se subjekti botues e financues i kontraktuar në cilësinë e sipërmarrësit, kishte marrë përsipër për t'i përlllogaritur dhe paguar në përputhje me dispozitat detyruese të legjislacionit tatimor³¹. Për mundësimin e tyre, subjekti shprehet se nuk mund të vinte në dispozicion dokumentet specifike të pagesave të tatimit në burim, me emrin e saj si përfituese e të ardhurave, por Komisioni mund t'i drejtohej botuesit lidhur me zotërimin e tyre.

1.16.x Lidhur me mospërputhjet e deklarimeve për këto të ardhura, gjatë hetimit administrativ dhe deklarimeve sipas procesverbalit të mbajtur në ILDKPKI, në datën 6.3.2012, ndër të tjera subjekti ka parashtruar se sqarimet ishin bërë në kushtet e pozicionit të saj si autore e librave, dhe jo si subjekt tregtar.

1.16.xi Në përfundim, subjekti ka parashtruar se pas analizimit të të gjitha burimeve për krijimin e kësaj pasurie, nuk pajtohet me Komisionin në përfshirjen e analizës financiare për vitet 2004 – 2006, të pagesës në shumën 8.000 euro, si shtesë të vlerës së paguar për këtë pasuri, mospërfshirjen e të ardhurave nga botimet e librave, pasi kishte paraqitur gjithë dokumentacionin e nevojshëm që provon realisht botimin, shitjen e tyre dhe tirazhin, duke nxjerrë vlerën reale të përfituar nga shitja e tyre. Gjithashtu, subjekti ka parashtruar në përlllogaritjet financiare se shpenzimet për vitin 2004 duhet të konsiderohen nga Komisioni në vlerën 0, pasi në këtë kohë kishte jetuar në të njëjtin trung familjar me prindërit.

Arsyetimi ligjor dhe analiza e provave në raport me faktet dhe me ligjin e zbatueshëm

1.17 Trupi gjykues, në analizë të provave të administruara, hetimit të kryer, deklarimeve të subjektit, si dhe parashtrimeve të saj në rezultatet e dërguara, lidhur me vërtetësinë e deklarimeve dhe burimet e ligjshme të kësaj pasurie arsyeton, si vijon:

1.17.i Në lidhje me vërtetësinë e deklarimeve për çmimin e kësaj pasurie në shumën 39.000 euro, trupi gjykues fillimisht ka marrë në analizë deklaratimet e subjektit në deklaratat periodike dhe atë “Vetting”, në raport me deklaratimet e dhëna nga subjekti gjatë hetimit administrativ, në shpjegimet e saj dhe me provat e depozituara pas kalimit të barrës së provës. Në analizë të tyre, trupi gjykues ka konstatuar se subjekti i rivlerësimit për herë të parë ka deklaruar në deklaratën periodike të viteve 2004 dhe 2005, se ka paguar shumën 12.000 euro në vitin 2004 dhe 23.000 euro në vitin 2005. Mbi këto deklarime, trupi gjykues konstaton se subjekti i rivlerësimit nuk ka deklaruar në deklaratën periodike të vitit 2005 detyrimin e pashlyer prej 4.000 euro sipas kontratës së porosisë. Po ashtu, rezulton se subjekti nuk ka deklaruar në deklaratën periodike të vitit 2006 pagesën e kryer në shumën 4.000 euro, sipas mandatit nr. (***) , datë 20.7.2006, si këst i fundit i parashikuar në kontratën e porosisë.

1.17.ii Lidhur me paqartësitë e 3 (tri) mandatpagesave të disponuara, specifikisht nr. (***) , datë 21.9.2004, në shumën 12.000 euro; nr. (***) , datë 25.7.2005, në shumën 23.000 euro dhe

³⁰Kontratë porosisë nr. (***) , datë 14.2.2012; kontratë sipërmartjeje e datës 25.10.2004.

³¹ Subjekti ka depozituar shkresë nr. (***) prot., datë 13.1.2020, të Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve, Tiranë.

nr. (***) , datë 20.7.2006, në shumën 4.000 euro, si dhe mandatit nr. (***) , datë 24.7.2006, në shumën 8.000 euro me përshkrimin “këst i fundit”, në një përlllogaritje formale matematikore krijohen dyshime mbi vlerën reale të paguar prej 39.000 euro.

Por, në raport me shpjegimet e subjektit, se shuma 8.000 euro është kthyer mbrapsht nga vlera totale e këstit të dytë prej 23.000 euro, trupi gjykues vlerëson se nëse merret në konsideratë: (i) mandati me nr. (***) , datë 23.5.2006, lëshuar nga përfaqësuesi i firmës, ku pasqyrohet dhënia e shumës prej 8.000 euro subjektit; (ii) mandati nr. (***) , datë 24.7.2006, ku pasqyrohet kthimi i kësaj shume nga subjekti në favor të shoqërisë ndërtimore; (iii) shpjegimet e subjektit se veprimet e kryera kanë ndodhur brenda të njëjtit vit kalendarik (2006); (iv) konstatimi se subjekti nuk ka deklaruar në deklaratën periodike të vitit 2006, pagesën e shumës 4.000 euro, por në të vërtetë është paguar sipas mandatit nr. (***) , datë 20.7.2006, atëherë në linjë logjike në tërësi për këta komponentë, do të çmohej se subjekti ka kryer deklaram të pasaktë në deklaratën periodike të vitit 2006.

Nën këtë analizë, trupi gjykues do të vlerësonte se kjo pasaktësi, duke qëndruar e vetme nuk do të mund të ngarkonte subjektin me përgjegjësi dhe as të passillte aplikimin e ndonjë mase disiplinore.

1.17.iii Por, trupi gjykues, situatën faktike e ka vlerësuar në analizë të provave të depozituara nga subjekti për të provuar veprimet e kryera në vitin 2006, për pagesat e kësaj pasurie dhe specifikisht dokumentacionin, fletë regjistri të spitalit, me anë të së cilës subjekti synon të provojë se veprimet financiare reciproke të tërheqjes së shumës prej 8.000 euro nga firma e ndërtimit, datë 23.5.2006 dhe ripagimi i saj në datën 24.7.2006, kanë qenë si rezultat i gjendjes shëndetësore të gjyshes së saj.

Pas verifikimit të dokumentacionit të depozituar nga vetë subjekti, trupi gjykues ka konstatuar se fleta e regjistrit të spitalit daton më 18.9.2006, ndërkohë që shuma prej 8.000 euro ishte marrë më 23.5.2006 dhe ishte kthyer më 24.7.2006. Ky fakt bën të pabesueshëm veprimet e kryera me këtë shumë për qëllime shëndetësore, si dhe shpjegimet e subjektit për vlerën reale të çmimit të paguar për këtë pasuri. Një argument tjetër logjik dhe i besueshëm do të kishte qenë depozitimi në ILDKPKI i të paktën mandatit të shumës prej 8.000 euro (i depozituar në Komision), në kohën kur subjekti është pyetur, ku pasqyrohet dhënia e shumës nga shoqëria ndërtimore për arsyet shëndetësore të pretenduara. Kjo do të përbënte provë për shkak se prej saj kishin ndodhur veprime përtej parashikimit kontraktor, në një kohë që në kontratë cilësohej se kësti i fundit i shlyerjes së pagesës së pasurisë ishte shuma 4.000 euro dhe jo 8.000 euro, ndërsa subjekti ka depozituar vetëm mandatin e ripagimit të shumës. Në këto kushte:

- ✓ Trupi gjykues, për efekt të këtij procesi, nuk i jep vlerë provuese fletës së regjistrit të spitalit, bashkëngjitur shkresës përcjellëse nr. (***) prot., datë 20.2.2020, lëshuar nga Drejtoria e Spitalit Rajonal Berat.
- ✓ Trupi gjykues vlerëson se mosdeklarimi i pagesës prej 4.000 euro në deklaratën e vitit 2006, si këst i fundit, sipas parashikimit kontraktor dhe për më tepër as edhe në deklaratën “Vetting”, standard ku kërkohej plotësimi me saktësi dhe vërtetësi i pasurive dhe i veprimeve të kryera me to, i të drejtave dhe detyrimeve, bën të pabesueshëm shpjegimet e subjektit në lidhje me vlerën reale të paguar për këtë pasuri.

1.17.iv Kjo situatë faktike, e ndërthurur me mosdeklarimet e pagesave reale, në deklaratën periodike të vitit 2006 dhe as në deklaratën “Vetting”, e gërshetuar edhe me kontradiktoritetin e krijuar me deklaramet e subjektit në shpjegimet e saj, mbi konstatimin e Komisionit se mandatet ishin dorëzuar vetëm gjatë hetimit administrativ, pasi kishte pasur bindjen se i rëndësishëm ishte pagimi i vlerës *de facto* i apartamentit dhe jo ruajtja e këtyre mandateve, ku

nga hetimi u konstatua se subjekti nuk ka deklaruar, pikërisht, në deklaratën periodike dhe atë “Vetting” pagesat reale *de facto* të kryera, çon trupin gjykues në konkluzionin se:

- ✓ Mosdeklarimet e kësteve të paguara në vitet përkatëse dhe për rrjedhojë të vlerës reale të çmimit të paguar për këtë pasuri, e vendosin subjektin në kushtet e deklarimit të pasaktë, në kundërshtim me parashikimin e gremës “a”, të pikës 5, të nenit 33, të ligjit nr. 84/2016, si dhe subjekti nuk shpjegoi bindshëm vlerën e paguar për këtë pasuri sipas nenit “D” të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë.

1.17.v Në lidhje me burimin e pagimit të këstit të dytë të kësaj pasurie, konkretisht, në lidhje me kredinë e marrë në “Alpha Bank” në datën 7.7.2005, në vlerën 2.500.000 lekë, trupi gjykues, në analizë të deklarimeve të subjektit, shpjegimeve të dhëna dhe provave të depozituara, arsyeton si vijon:

1.17.vi Për sa i përket ligjshmërisë së përfitimit të kredisë, dokumentacioni i administruar ka provuar miratimin dhe *disbursimin* e saj.

Në ndryshim nga provueshmëria në nivel institucional për përfitimin e kredisë, subjekti kishte barrën e provës për të provuar konstatimin e trupit gjykues se pas *disbursimit*, rezultoi se nga llogaria e kredisë, subjekti kishte kryer dy transaksione, përkatësisht, në datën 7.7.2005, në shumën 1.230.000 lekë dhe në datën 13.7.2005, po në shumën 1.230.000 lekë, për të cilat nuk identifikohet përshkrimi i këtyre transfertave dhe as përfituesi i tyre.

Trupi gjykues nuk konstaton që subjekti të ketë depozituar ndonjë provë për të qartësuar veprimet bankare të kryera pas *disbursimit*, për të identifikuar pritësin e dy transfertave, tërheqjen e tyre dhe më tej kalimin për llogari të shoqërisë ndërtimore.

Trupi gjykues konstaton që subjekti nuk provoi me dokumentacion justifikues destinacionin e kredisë, por me shpjegimet e saj i ka kushtuar rëndësi faktit *se kësti i dytë i pasurisë në shumën 23.000 euro ka kaluar për shitësin me mandatpagesë*.

Sigurisht është provë e pakundërshtueshme veprimi i kryer nëpërmjet mandatit përkatës, por krijimi i shumës së paguar nuk vlerësohet se duhet të jetë thjesht dhe vetëm një përlllogaritje matematikore se po ajo shumë që është përfituar kredi të jetë konkretisht kjo që pasqyrohet në mandatpagesën, meqenëse kjo e fundit daton pas përfitimit të kredisë.

Trupi gjykues vlerëson se nuk janë këta elementët provues, të cilët indirekt mund të legjitimojnë kredinë e përfituar si e kaluar në favor të këstit të dytë për blerjen e pasurisë.

Ndërsa, subjekti, si gjatë hetimit administrativ, por edhe në prapësime u mjaftua të ripërsëriste faktin që kredia është përfituar nëpërmjet marrëdhënieve kontraktore, është *disbursuar* në favor të saj dhe me atë shumë është paguar sipas mandatit përkatës, kësti i dytë i pasurisë.

Gjatë seancës dëgjimore subjekti ka deklaruar se mesa kujtonte meqenëse edhe koha është e largët se kjo kredi në monedhën Lek është kaluar me dy transaksione në llogari të një të treti, përkatësisht *exchange* për tu konvertuar në monedhën Euro pasi dhe pagesat e kësaj pasurie ishin po në këtë monedhë. Pas këtij këmbimi, subjekti ka deklaruar se i ka tërhequr në monedhën euro rreth 23.000 euro, çka përbënte edhe këstin e paguar për këtë pasuri. Përkundëjt këtij deklarimi, subjekti nuk depozitoi asnjë dokumentacion justifikues për të provuar këto transaksione, si dhe nuk arriti të provojë nëse ndodhej në pamundësi objektive për të disponuar dokumentin, sipas parashikimeve të nenit 32/2 të ligjit nr.84/2016.

Subjekti nuk bëri asnjë përpjekje për të provuar se në llogari të kujt kishin kaluar dy transaksionet e bëra prej saj të shumës së kredisë, pra, thënë ndryshe kush ishte përfituesi i drejtpërdrejtë i tyre pas *disbursimit*.

Po ashtu, subjekti nuk provoi tërheqjen e shumës dhe në këtë kontekst pretendimet e saj mbetën tërësisht në nivel deklarativ.

Në kushte të tilla:

- ✓ Trupi gjykues çmon se subjekti nuk arriti të provojë destinacionin e kredisë së përfituar në shumën 2.500.000 lekë, në “Alpha Bank” dhe për pasojë nuk arriti të shpjegojë bindshëm njërin prej burimeve të kësaj pasurie (deklaruar me këtë kredi), në kundërshtim me pikën 3 të nenit “D” të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë.
- ✓ Trupi gjykues vlerëson se subjekti ka kryer deklarim të pasaktë, në kundërshtim me parashikimin e germës “a”, të pikës 5, të nenit 33, të ligjit nr. 84/2016.

1.17.vii Ndërsa në lidhje me shlyerjen e kësaj kredie, nga hetimi ka rezultuar se subjekti ka deklaruar se për ta shlyer para kohe ka marrë hua shumën 1.200.000 lekë, në vitin 2010, nga shtetasja G. N. . Komisioni hetoi në lidhje me ligjshmërinë e krijimit të kësaj shume nga huadhënësja, nga ku i rezultoi se:

1.17.viii Subjekti e deklaroi këtë hua në deklaratën “Vetting” në rubrikën “të dhëna konfidenciale” me përshkrimin “G. N., huadhënëse në kontratën e huadhënies, vajza e tezes së deklarueses, të ardhura të siguruara nga kursimet e saj familjare dhe të bashkëshortit gjatë emigracionit”.

1.17.ix Në deklaratën periodike vjetore të vitit 2010, subjekti e deklaroi huan në zërin e detyrimeve financiare për kredinë e marrë në “Alpha Bank”, me përshkrimin “shlyerje në datën 6.10.2010, shuma 1.200.000 lekë, shumë e marrë hua në datën 2.4.2010”.

1.17.x Kjo hua konfirmohet me kontratë huadhënieje³² nr. (***) , datë 2.4.2010, me huadhënës shtetasen G. N. dhe huamarrëse shtetasen Bernina Kondi. Në të citohet shuma 1.200.000 lekë e dhënë hua pa interes, me afat kthimi brenda datës 2.4.2020.

1.17.xi Sipas *statement* bankar në BKT³³, rezultoi se kjo hua është kthyer në datën 20.9.2019, nga llogaria e znj. Bernina Kondi në llogari të znj. G. N. me përshkrimin “kthim huaje sipas kontratës, huadhënie datë 2.4.2010, nr. (***)”.

1.17.xii Komisioni e ka pyetur³⁴ subjektin për burimin e ligjshëm të shumës së dhënë hua dhe për këtë, ka depozituar një deklaratë noteriale nr. (***) , datë 9.9.2019, sipas së cilës huadhënësia G. N. deklaroi se ka marrë hua shumën prej 10.000 euro te shtetasi A. G, në datën 22.8.2009, me afat likuidimi brenda datës 22.8.2024. Qëllimi i specifikuar i huamarrjes rezultoi “për të hapur aktivitet privat, parukeri”, të cilin nuk ka mundur ta hapë deri më sot.

1.17.xiii Në procesverbalin e mbajtur në ILDKPKI, datë 6.3.2012, kur subjekti është pyetur në lidhje me këtë hua është shprehur se: “*Bashkëshorti i znj. G. N. ka biznes privat dhe disponon të ardhura të mjaftueshme*”.

1.17.ivx Nga korrespondenca e Komisionit me Fondin Besa³⁵ rezultoi se shtetasja G. N. ka marrë një kredi pranë këtij institucioni në datën 25.6.2015, në shumën 150.000 lekë me afat 12 muaj, detyrim, i cili vijon të jetë aktiv. Në këto rrethana dukej se huadhënësia nuk justifikon me dokumentacion, burimin e krijimit të shumës 1.200.000 lekë.

1.17.xv Gjatë hetimit ka rezultuar se subjekti në deklaratën periodike të vitit 2009 ka deklaruar gjendje *cash* në shumën 2.500.000 lekë dhe shtesë të saj përgjatë vitit 2010, duke arritur në

³²Aneks 4/7 në dosjen e ILDKPKI-së.

³³ Shkresë nr. (***) prot., datë 5.11.2019, nga BKT-ja, në dosjen e Komisionit.

³⁴ Pyetësori nr. 2, datë 16.12.2019, në dosjen e Komisionit.

³⁵ Shkresë nr. (***) prot., datë 30.10.2019, në dosjen e Komisionit.

vlerën 3.500.000 lekë. Në kushte të tilla, Komisioni ngriti dyshimin e arsyeshëm se përse nevojitej marrja e huas kur subjekti zotëronte gjendje *cash* në një shumë të konsiderueshme.

1.17.xvi Fakti që subjekti nuk provoi burimin e ligjshëm të huadhënësit, sipas parashikimit të bërë në pikën 3 të nenit “D” të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, Komisioni nuk e ka marrë në konsideratë këtë huadhënie në analizën e kryer, paraqitur në tabelën e mëposhtme.

Tabela nr. 3

Nr.	Përshkrimi	2010
1	TË ARDHURA	1,842,614
	Të ardhura nga paga subjekti	938,688
	Të ardhura nga paga bashkëshorti	903,913
	Të ardhura nga interesat bankare	13
2	SHPENZIME	2,601,507
	Shpenzime jetese sipas ILDKPKI-së	409,860
	Shpenzime arredimi ³⁶	95,100
	Shpenzime <i>TIMS</i>	62,465
	Shpenzime telefoni	160,039
	Kredi në “Alpha Bank” (7.10.2005) (2.500.000 lekë)	1,874,043
	Huamarrje nga G. N. (2.4.2010)	-
3	PASURI	957,224
	Pasuri e paluajtshme/e luajtshme	
	<i>Ndryshim likuiditeti</i>	957,224
	DIFERENCA (1-2-3)	-1,716,117

1.17.xvii Për të gjitha faktet e sipërpërmendura, për të qartësuar çdo situatë në lidhje me këtë burim/huan, si dhe pas analizës financiare të kryer nga Njësia e Shërbimit Ligjor, Komisioni i kaloi subjektit barrën e provës³⁷ pasi: (i) dukej se subjekti nuk kishte pasur mundësi financiare në shumën 1.716.117 lekë për të shlyer kredinë, të shtojë gjendjen *cash*, si dhe të përballojë shpenzimet e tjera familjare; (ii) dukej se nuk provohej me dokumentacion justifikues burimi i ligjshëm i shumës së dhënë hua nga shtetasja G. N.; (iii) dukej se subjekti ka ndryshuar gjatë hetimit administrativ burimin e krijimit të shumës së dhënë hua, pasi në deklaratën “Vetting” deklaroi në rubrikën “të dhëna konfidenciale” “G. N., huadhënëse në kontratën e huadhënies, vajza e tezes së deklaruases, të ardhura të siguruara nga kursimet e saj familjare dhe të bashkëshortit të saj gjatë emigracionit”, në procesverbalin e ILDKPKI-së ka deklaruar si burim të kësaj huaje të ardhurat nga biznesi privat i bashkëshortit të znj. G. N., ndërsa në deklaratën noteriale të depozituar në pyetësor deklarohet se kjo shumë është marrë hua edhe nga vetë shtetasja G. N.; (iv) dukej se nuk përbënte logjikë ekonomike marrja e huas në vitin 2010, ndërkohë që subjekti dhe bashkëshorti i saj sipas deklaramit dispononin gjendje *cash* në shumë të konsiderueshme, disa herë më të lartë sesa shuma 1.200.000 lekë e marrë hua.

³⁶ Komisioni vlerësoi ta shpërndajë këtë shpenzim në tri vitet e para nga momenti që apartamenti është bërë funksional për apartamentin në adresën Rr. “(***)”, Tiranë në raportin 40 %, 30 % dhe 30 % (meqë subjekti ka qenë i transferuar në Berat), si dhe në dy vitet e para për apartamentin në adresën Rr. “(***)”, Tiranë në raportin 60 % vitin e parë dhe 40 % në vitin dytë. Është bërë kjo ndarje e shpenzimit për sa kohë që subjekti nuk ka deklaruar një shpërndarje konkrete për arredimin, si dhe për faktin se në vitet e para kryhen shpenzimet më thelbësore për funksionalitetin e një banese.

³⁷Bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016.

Qëndrimi i subjektit në lidhje me faktet e konstatuara nga Komisioni

1.17.xviii Në lidhje me konstatimet e Komisionit për burimin e ligjshëm të shumës së dhënë hua nga shtetasja G. N., subjekti ka parashtruar se kishte lidhur kontratën e huadhënies nr. (***) , datë 2.4.2010 me vajzën e tezes në shumën 1.200.000 lekë, e cila referuar *statement-ve* bankare, tregonte qartë qëllimin e saj, mbylljen e kredisë së marrë në “Alpha Bank”.

1.17.ixx Lidhur me dyshimin që kishte ngritur Komisioni për ndryshim të burimit të krijimit të shumës, subjekti ka dhënë të njëjtat shpjegime gjatë hetimit administrativ dhe në mënyrë të përmbledhur ka shpjeguar se situata e krijuar realisht lidhej me mungesën e informacionit që kishte pasur. Nga momenti që Komisioni i kishte kërkuar të provonte burimin e ligjshëm të kësaj huaje, është sqaruar me vajzën e tezes, znj. G. N., se kjo hua kishte qenë e mëparshme dhe e marrë nga shtetasi A. G. për hapje biznesi privat. Për të provuar këto fakte subjekti ka vendosur në dispozicion të Komisionit, deklaratën noteriale nr. (***) , datë 9.9.2019, sipas së cilës huadhënësia G. N. deklaroi se ka marrë hua shumën 10.000 euro te shtetasi A. G., në datën 22.8.2009, me afat likuidimi brenda datës 22.8.2024, me qëllim hapje të aktivitetit privat, parakeri, të cilin nuk ka mundur ta hapte deri më sot, si dhe dokumentacionin³⁸ për të provuar të ardhurat e ligjshme të shtetasit A. G. .

1.17.xx Në vijim, subjekti ka parashtruar se në analizën financiare me shpjegimet dhe provat e sjella huaja duhet të konsiderohet burim i ligjshëm, ndërkohë duhet të rishikohen nga Komisioni përllogaritjet lidhur me analizën e shpenzimeve *TIMS*, në vlerën 62,465 lekë të rrugëve jashtë vendit, pasi sipas sistemit *TIMS* dhe kopjes së pasaportës, subjekti pretendon se nuk ka dalë asnjëherë jashtë territorit të Shqipërisë në vitin 2010. Në këto shpenzime duhet të zbriten pagesat e 4 ditëve të udhëtimit të bashkëshortit, pasi ishin parapaguar nga institucionet punëdhënëse të tij, duke depozituar dokumentacionin³⁹ për të provuar faktet e pretenduara. Mbi përllogaritjet financiare subjekti ka kontestuar përllogaritjet lidhur me shpenzimet e telefonit, pasi nga Komisioni ishte llogaritur shpenzim i telefonit shuma prej 160.039 lekësh, si një shpenzim i paguar në total nga të ardhurat e saj në vitin 2010. Shpenzimet e telefonit sipas subjektit ishin mbuluar nga punëdhënësi duke depozituar edhe dokumentacion⁴⁰ provues për këtë fakt.

1.17.xxi Po për përllogaritjet financiare të Komisionit, subjekti ka shpjeguar lidhur me gjendjen *cash* në shumën 2.500.0000 leke, që sipas saj kjo shumë ishte krijuar nga të ardhurat e bashkëshortit të saj ndër vite dhe nuk ishte një e ardhur e krijuar nga kontributi i të dyve gjatë periudhës që kishin qenë të martuar. Sipas certifikatës martesore të depozituar, martesë ishte lidhur në datën 2.10.2009, për rrjedhojë nuk mund të përdorte kursimet e bashkëshortit të realizuara në periudhën para martesë. Këto të ardhura sipas subjektit do të investoheshin për të blerë një banesë të përbashkët meqenëse deri në ato momente nuk dispononin asnjë të tillë për të cilën kishin aplikuar për një kredi të butë dhe kushti i përfitimit të kësaj kredie ishte mbyllja e menjëhershme e kredisë së parë bankare të marrë tek “Alpha Bank”, pasi nuk mund ta përfitonte, për shkak se pasja e një kredie të mëparshme ishte kusht ndalues.

³⁸*Busta paga* (pagesat mujore) të shtetasit A. G., lëshuar në formën e kërkuar nga ligji me vulë apostile për periudhën nga viti 2007 e në vazhdim, konfirmuar ky fakt para noterit; karta e identitetit me nr. (***) , të shtetasit A. G. lëshuar nga Komuna Gorgo Al Monticano, lëshuar në formën e kërkuar nga ligji me vulë apostile; vërtetim i lëshuar nga administratori i shoqërisë italiane I. C..

³⁹Urdhër nr. (***) , i datës 8.11.2010, drejtuar Sektorit të Buxhetit, Kontabilitetit dhe Investimeve pranë Prokurorisë së Përgjithshme; shkresa nr. (***) prot/S.P , datë 19.2.2020, ‘Kthim përgjigje’ bashkëlidhur tabela përkatëse.

⁴⁰Vërtetimin nr. (***) prot., të datës 19.2.2020, lëshuar nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Berat, faturat e shpenzimeve të telefonit celular për periudhën 2010 – 2012.

1.17.xxii Në lidhje me ndryshimin e likuiditeteve subjekti ka shpjeguar se në deklarin e pasurisë, ndër vite, ka pasqyruar në të gjitha rastet vetëm ndryshimin në lidhje me shtesën e likuiditeteve në fund të periudhave përkatëse (vitet) sipas përcaktimeve ligjore dhe orientimit të formularëve përkatës dhe jo gjendjes totale të likuiditeteve të akumuluar nga vitet e mëparshme plus shtesën e vitit përkatës. Në këto kushte, në vitin 2010 nga gjendja e likuiditeteve të akumuluar nga vitet e mëparshme ishte shpenzuar një pjesë e vogël e tyre, afërsisht 400.000 lekë, si nevojë e përballimit të të gjitha shpenzimeve jetësore familjare gjatë vitit 2010. Subjekti ka parashtruar se duke i marrë në konsideratë të gjitha shpjegimet e justifikuara me prova, arrihej rezultati se si subjekt vlerësimi ka pasur mundësi financiare për të shlyer kredinë, të justifikojë gjendjen *cash*, si dhe të përballojë shpenzimet e tjera familjare.

Arsyetimi ligjor dhe analiza e provave në raport me faktet dhe me ligjin e zbatueshëm

Në lidhje me huan e marrë shtetas G. N., trupi gjykues ka konstatuar gjetjet, duke lënë edhe barrën e të provuarit, për shkak se ka vërejtur deklarime kontradiktore të subjektit lidhur me burimin e krijimit të huasë. Përveç këtij konstatimi parësor, trupi gjykues ka vërejtur edhe faktin tjetër se huadhënësja rezultonte vetë kredimarrëse madje edhe në vështirësi të shlyerjeve të kredisë. Provueshmëria nga subjekti lidhur me ligjshmërinë e huas është një kërkesë ligjore, bazuar në pikën 3 të nenit “D” të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, por edhe përmbushje e kërkesave të ligjit nr. 84/2016. Në këtë kontekst, synimi i Komisionit ka qenë vërtetësia e deklarimeve të bëra nga subjekti, si dhe provueshmëria e burimit të krijimit të huas.

Në analizë të deklarimeve kontradiktore të subjektit në deklaratat periodike, në procesverbalin e mbajtur nga ILDKPKI-ja, në deklaratën “Vetting” dhe më tej përgjatë hetimit administrativ, në raport edhe me prapësimet e depozituara dhe provat shoqëruese, në lidhje me burimin e krijimit të huas, trupi gjykues vlerëson se subjekti pasi ka dështuar të provojë ligjshmërinë e saj, sikurse ka deklaruar se ishte krijuar mbi të ardhura të siguruar nga kursimet familjare të huadhënësës dhe të bashkëshortit të saj gjatë emigracionit, apo nga të ardhurat nga biznesi privat i bashkëshortit të huadhënësës, ka bërë përpjekje për të arritur nivelin e provueshmërisë, duke e transferuar ligjshmërinë e huas tek të tretë, të cilët nuk cilësohen nga kërkesat e ligjit nr.84/2016 si persona të lidhur. Trupi gjykues, duke iu përmbajtur kërkesave të ligjit, shprehet vetëm mbi deklarin e subjektit dhe për pasojë në këtë rast lehtësisht është e provuar se subjekti nuk arriti të provojë burimin e ligjshëm të krijimit të shumës 1.200.000 lekë të marrë hua nga shtetasja G. N. . Fakti që subjekti deklaroi gjatë hetimit dhe në prapësime se shuma nga huadhënësja i ishte marrë të tretëve, duke depozituar deklaratën noteriale nr. (***) , datë 9.9.2019, ku shtetasja G. N. deklaroi se ka marrë hua shumën 10.000 euro te shtetasi A. G. në datën 22.8.2009, me afat likuidimi brenda datës 22.8.2024, si dhe fakti që subjekti depoziton edhe deklaratën noteriale të shtetasit A. G., datë 26.2.2020, i cili shfaqet si dhënësi i shumës 10.000 euro për llogari të shtetas G. N., janë argumente të pakundërshtueshme për sa kohë ajo ka deklaruar periodikisht apo edhe në “Vetting” shtetasen G. N. si huadhënëse, ka kryer deklarin të pamjaftueshëm lidhur me ligjshmërinë e burimit të shumës dhe se drejtpërdrejtë provohet se kjo shtetase nuk kishte pasur burime të ligjshme për krijimin e huas. Megjithatë, trupi gjykues nuk ka shmangur administrimin e provave të depozituara nga subjekti me prapësimet e saj dhe njëkohësisht as edhe njohjen dhe verifikimin e tyre. Konkretisht, rezultoi se të dyja deklaratat, përkatësisht e dhënë nga shtetasja G. N. dhe deklarata e shtetasit A. G. dhënë në Itali janë realizuar vetëm gjatë hetimit administrativ. Ajo që konstatohet në të dyja deklaratat është fakti se shtetasi A.G. ka dhënë shumën 10.000 euro shtetas G. N. në gusht të vitit 2009. Pas verifikimeve të kryera në sistemin *TIMS*, nga hyrje - daljet për vitin kalendarik 2009, rezulton se shtetasi A. G. jo vetëm në këtë muaj nuk ka hyrë në Shqipëri, por as edhe përgjatë këtij viti. Në kushte të tilla, deklarimi se burimi i kësaj shume është huaja e marrë nga shtetasja G. N., shtetasit A. G., është i pavërtetë dhe se pretendimet e subjektit mbeten jo vetëm në nivel deklarativ, por edhe në nivel kontradiktor.

Në përfundim të këtij arsyetimi, trupi gjykues çmon se:

- ✓ Bazuar në pikën 3, të nenit D, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, subjekti i rivlerësimit nuk arriti të shpjegojë bindshëm burimin e ligjshëm të krijimit të shumës 1.200.000 lekë, deklaruar si hua e marrë shtetas G. N. dhe për pasojë kjo shumë nuk mund të përfshihet në analizën financiare të vitit 2010.

1.17.xxiii Ndërsa, në lidhje me pretendimet e subjektit se në analizën financiare duhet të rishikohen nga Komisioni, përlogaritjet lidhur me analizën e shpenzimeve *TIMS* në vlerën 62,465 lekë të rrugëve jashtë vendit, pasi sipas sistemit *TIMS* dhe kopjes së pasaportës, subjekti nuk ka dalë asnjëherë jashtë territorit të Shqipërisë në vitin 2010, trupi gjykues pasi mori në shqyrtim provat e depozituara konstaton se vërtetë subjekti nuk ka kryer asnjë udhëtim jashtë vendit për vitin 2010, por bashkëshorti i saj rezulton të ketë dalë dy herë. Nga dokumentacioni i depozituar nga Prokuroria e Përgjithshme, rezulton vetëm një udhëtim për qëllime pune. Këtë udhëtim, Komisioni nuk e ka përfshirë si shpenzim në analizën financiare të dërguar subjektit në rezultatet e hetimit. Për udhëtimin tjetër, i kryer në datat 26-30 prill 2010, i cili pretendohet si udhëtim pune, subjekti nuk ka depozituar asnjë dokumentacion provues. Për pasojë, ky pretendim për uljen e shpenzimeve të këtij udhëtimi në shumën 62.465 lekë, nuk qëndron dhe nuk është marrë në konsideratë.

1.17.xxiv Edhe në lidhje me pretendimin tjetër të subjektit se në analizën financiare shpenzimet e telefonit në shumën prej 160.039 lekë nuk duhet ti vishen subjektit pasi janë paguar nga punëdhënësi për shkak të detyrës, Trupi gjykues pasi u njoh dhe analizoi dokumentacionin⁴¹ e depozituar në prapësime, vlerësoi të kryejë rillogaritjet përkatëse⁴² duke e quajtur të drejtë pretendimin e subjektit dhe në përfundim të kryerjes së analizës financiare konstatoi se subjekti mbetet në balancë negative për vitin 2010 nga shuma 1.716.117, në shumën 1.593.639 lekë.

Në përfundim të analizimit të komponentëve më sipër, të cilët i përkasin veprimeve të kryera nga subjekti në vitin 2010, trupi gjykues arrin në konkluzion se subjekti:

- ✓ Gjendet në balancë negative për vitin 2010, në shumën 1.593.639 lekë.

1.17.xxv Në vijim të arsyetimit, lidhur me konstatimin tjetër të Komisionit se nuk përbënte logjikë ekonomike fakti që në të njëjtën kohë subjekti administronte të ardhura të konsiderueshme dhe nga ana tjetër merrte hua, trupi gjykues ka konsideruar pretendimet e subjektit se pavarësisht se bashkëshortët administronin një shumë të konsiderueshme në vitin 2010, ajo kishte synuar marrjen e huas për të mos prekur shumën 2.500.000 lekë *cash* të krijuar nga kursimet e bashkëshortit para martese dhe se këtë shumë e kishin përcaktuar për ta përdorur për një destinacion tjetër.

- ✓ Këtë argumentim, trupi gjykues e konsideron të pranueshëm dhe për pasojë nuk i jep vlerë në konkluzionet e kësaj vendimmarrjeje.

➤ **Në lidhje me të ardhurat e mbledhura nga shitja e librave të botuara prej subjektit, në vlerën 1.000.000 lekë**

Arsyetimi ligjor dhe analiza e provave në raport me faktet dhe me ligjin e zbatueshëm

1.18 Trupi gjykues, në analizë të deklaramëve të subjektit, shpjegimeve të dhëna dhe provave të depozituara (shih pikat 1.16.viii; 1.16.ix dhe 1.16.x më sipër) arsyeton, si vijon :

1.18.i Për sa i përket deklaramit të të ardhurave janë evidentuar saktësisht në deklaratën periodike për vitin 2004. Përveç këtij deklarami, fillimisht, Komisioni nuk konstatoi asnjë të

⁴¹Vërtetimin nr. (***) prot., të datës 19.2.2020, lëshuar nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Berat, faturat e shpenzimeve të telefonit celular për periudhën 2010 – 2012.

⁴²Duke kryer diferencën mes shumës së paguar nga institucioni dhe asaj të paguar nga llogaria bankare e subjektit.

dhënë tjetër që provonte përfitimin e këtyre të ardhurave dhe as të dhëna tatimore mbi burimin e ligjshëm të tyre.

Ndërsa, nga analizimi i përgjigjeve⁴³ të dhëna përpara ILDKPKI-së, në vitin 2012, konstatohej se subjekti kishte pohuar se në lidhje me të ardhurat e realizuara nga shitja e librave nuk kam fatura pasi këto libra janë shitur në librari të ndryshme dhe në sasi të ndryshme.

Në vijim, rezultoi se subjekti nuk kishte treguar kujdesin e duhur të përmbushte qëllimin e legjislacionit të fushës për të provuar së bashku me dorëzimin e deklaratës “Vetting” edhe dorëzimin e dokumentacionit që provonte marrëdhënien me botuesin e librave.

Ndërsa gjatë hetimit, subjekti provoi bashkëpunimin me botuesin e librave nëpërmjet depozitimit të kontratave të bashkëpunimit të datës 9.1.2002 dhe 3.2.2003, si dhe depozitoi 25 mandatpagesa për të ardhurat nga botimet e dy librave.

Pra, nga njëra anë subjekti pohon mosekzistencën e faturave lidhur me shitjet e librave, duke dhënë edhe argumentin *se janë shitur në librari të ndryshme*, nga ana tjetër depoziton mandate gjatë hetimit administrativ.

Përveç qëndrimeve të ndryshme të subjektit lidhur me provueshmërinë e këtyre të ardhurave, nga ILDKPKI-ja dhe në Komision, përballë faktit të depozitimit të mandateve dhe administrimit të tyre nga Komisioni, çështja shtrohet në provueshmërinë e ligjshmërisë së të ardhurave të krijuara, në përputhje me pikën 3 të nenit “D” të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë.

Trupi gjykues, në analizë të kontratave përkatëse nuk konstatoi qartësisht se kujt i mbetet detyrimi për të shlyer tatimin mbi të ardhurat e krijuara, por duke analizuar përgjigjen⁴⁴ e dhënë nga Drejtoria Tatimore Tiranë, ku qartësohej se detyrimi ka qenë i botuesit, ku dhe konfirmohej se ky detyrim nuk është shlyer, atëherë qartësimi në nivel teknik i institucionit të fushës përbën provë dhe, për pasojë, trupi gjykues çmon se në këtë rast subjekti nuk mund të vishet me përgjegjësi.

1.18.ii Gjithashtu, trupi gjykues në këtë çështje vlerëson edhe faktin se të ardhurat janë krijuar përpara se subjekti të kishte nisur ushtrimin e funksionit të saj si gjyqtare, pra, përpara se të bëhej subjekt deklarimi. Në këto kushte, pavarësisht se nga njëra anë mbahen në konsideratë rrethana të tilla, që lidhen me të ardhura të krijuara përpara detyrës, në anën tjetër është konkluduar se në balancën negative të konstatuar në vitin 2004, në shumën 94.153 lekë, nuk ka pasur rol vendimtar mospërfshirja e kësaj shume, megjithëse e kontestuar nga subjekti.

1.18.iii Pra, ndërsa trupi gjykues vlerësoi nëpërmjet kësaj analize ligjshmërinë e këtyre të ardhurave çmon se në raport edhe me balancën negative, përfshirja e tyre thjesht dhe vetëm eliminon shumën prej 94.153 lekësh dhe, për pasojë, subjekti nga rilloaritjet financiare për vitin 2004 gjendet në balancë pozitive.

Në kushte të tilla, trupi gjykues çmon se:

- ✓ Mospërputhjet e deklaramit të subjektit se në *lidhje me të ardhurat e realizuara nga shitja e librave nuk ka fatura, pasi këto libra janë shitur në librari të ndryshme dhe në sasi të ndryshme* me veprimin e kryer gjatë hetimit, ku depozitoi 25 mandatpagesa, ndikojnë në vlerësimin etik të subjektit të rivlerësimit.
- ✓ Lidhur me ligjshmërinë e krijimit të kësaj shume, nuk konstatohen problematika.

2. Në lidhje me apartament banimi me sip. 90.12 m², kati IV, ndërtuar nga shoqëria “SH.” sh.p.k., me adresë: rruga “(*)”, Tiranë, përfituar me kontratë sipërmarrje datë 1.10.2011. Vlera totale e apartamentit 8.200.000 lekë. Pjesa zotëruese: 50 %. Burimi i deklaruar i krijimit:**

⁴³ Proceduar sipas pikës 5, të nenit 32, të ligjit nr. 84/2016, ku thuhet shprehimisht: “*Deklarimet e interesave private dhe pasurore, të paraqitura më parë tek ILDKPKI-ja mund të përdoren si provë nga Komisioni dhe Kolegji i Apelit*”.

⁴⁴ Subjekti ka depozituar shkresë nr. (***) prot., datë 13.1.2020, të Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve, Tiranë.

kredia e marrë nga BKT në datën 12.11.2010, në shumën 5.000.000 lekë, me afat 25-vjeçar, si dhe kursimet familjare (paraqitur dhe kopje të mandatarkëtimeve përkatëse). Subjekti i ka bashkëlidhur deklaratës disa dokumente⁴⁵.

2.1 ILDKPKI-ja, në raportin e saj, ka konstatuar se:

- Subjekti shmang transaksionet bankare dhe kryen transaksione *cash* në shuma të konsiderueshme dhe, konkretisht, shumën totale 8.200.000 lekë për një afat rreth 2-mujor për blerjen e apartamentit në Tiranë.
- Sipas DPPPP-së shoqëria “SH.” sh.p.k., ka raportuar pagesën e kryer nga znj. Bernina Kondi në shumën 5.000.000 lekë, dhe jo pagesën totale 8.200.000 lekë. Gjithashtu raportimi i shoqërisë se pagesa është kryer në nr. e llogarisë në BKT nuk është raportuar nga kjo bankë në DPPPP, çka krijon dyshime për veprimet e kryera.

Hetimi i kryer nga Komisioni

2.2 Nga korrespondenca e mbajtur me ASHK, Drejtoria Vendore Tiranë Rurale⁴⁶ 2, Drejtoria Vendore Tiranë Rurale⁴⁷ 1, Drejtoria Vendore Tiranë Veri⁴⁸, Drejtoria Vendore Tiranë Jug⁴⁹, nuk konfirmojnë ekzistencën e kësaj pasurie.

2.3 Subjekti e deklaroi për herë të parë këtë pasuri në deklaratën periodike vjetore të vitit 2011 me përshkrimin “kontratë noteriale (sipërmarrje) me nr. (***) , datë 01.10.2011. Apartament nr. (***) , kati (***) , rruga “(***)” , Tiranë, sip. 90.12 m². Vlera e blerjes 8.200.000 lekë. Pagesa është bërë me BKT + kursime familjare, bashkëshortit”.

2.4 OSHEE-ja, me shkresën nr. (***) prot., datë 29.10.2019, konfirmon një abonent me kontratë furnizimi nr. (***) , në emrin e znj. Bernina B. Kondi, në adresën: rruga “(***)” , Sh. .

2.5 UKT-ja, me shkresën nr. (***) prot., datë 25.10.2019, konfirmon kontratën nr. (***) në emër të znj. Bernina B. Kondi, me status aktiv në rrugën “(***)” , Tiranë.

2.6 Kjo pasuri konfirmohet me anë të aktmarrëveshjes - kontratë sipërmarrje⁵⁰ datë 1.10.2011, mes palëve: shoqëria “SH.” sh.p.k., dhe porositës shtetasit Bernina Kondi dhe E. K. . Sipërfaqja totale e apartamentit është 90.12 m². Vlera e apartamentit: 8.200.000 lekë. Sipas kësaj kontrate parashikimi për likuidimet është pasqyruar si më poshtë:

- Me firmosjen e kësaj kontrate porositësit paguajnë shumën 5.000.000 lekë.
- Mbetjen prej 3.200.000 lekësh porositësit do ta paguajnë në dy këste:
 - a) kësti i parë do të paguhet në fund të tetorit; dhe
 - b) kësti i dytë do të paguhet në fund të nëntorit.

Në aktmarrëveshje (referuar objektit të aktit) është parashikuar se likuidimi mes palëve do të vërtetohet me deklaratë të firmosur nga të dyja palët.

Komisioni ka konstatuar se dukej se mungonte ky akt dhe, për pasojë, i ka kaluar subjektit barrën e provës⁵¹.

⁴⁵Aktmarrëveshje - kontratë sipërmarrje, datë 1.10.2011; leje ndërtimi nr. (***) + vendim KRRT nr(***)+ planimetri + vërtetim nr. (***) datë 1.10.2011; mandatpagesa datë 25.10.2011, në vlerën 2.000.000 lekë, datë 28.11.2011, në vlerën 1.200.000 lekë dhe datë 1.10.2011, në vlerën 5.000.000 lekë (aneksi nr. 4/3, në dosjen e ILDKPKI-së).

⁴⁶ Referohuni shkresës nr. (***)prot., datë 8.11.2019, në dosjen e Komisionit.

⁴⁷ Referohuni shkresës nr. (***) prot., datë 8.11.2019, në dosjen e Komisionit.

⁴⁸ Referohuni shkresës nr. (***) prot., datë 11.11.2019, në dosjen e Komisionit.

⁴⁹ Referohuni shkresës nr. (***) prot., datë 11.11.2019, në dosjen e Komisionit.

⁵⁰ Aneks 4/3 në dosjen e ILDKPKI-së.

⁵¹ Bazuar në nenin 52, të ligjit nr. 84/2016 dhe paragrafit 3 dhe 5, të nenit D, të Aneksit të Kushtetutës.

Subjekti, në prapësimet e saj, ka depozituar akt “deklaratë” të datës 28.11.2011, e cila provon faktin se likuidimi mes palëve është vërtetuar me deklaratë të firmosur nga të dyja palët, nga porositi Bernina Kondi dhe nga përfaqësuesi ligjor i shoqërisë “SH.” sh.p.k., z. F. Sh. .

- ✓ Në këto kushte, trupi gjykues konstaton se provohet me dokumentacion përbushja e kushtit kontraktor mbi likuidimin e palëve për fitimin e kësaj pasurie.

2.7 Në vijim të hetimit të kryer nga Komisioni, subjekti është pyetur⁵² për mënyrën e likuidimit të kësaj pasurie nga ku subjekti ka depozituar tri mandatpagesa për shoqërinë “SH.” sh.p.k., me shumat përkatëse:

Tabela nr. 4

Nr.	Data	Vlera	Dokumentacioni
Extra	01.10.2011	5,000,000	Mandatarkëtimi
Extra	25.10.2011	2,000,000	Mandatarkëtimi
Extra	28.11.2011	1,200,000	Mandatarkëtimi
		8,200,000	

2.7.i Nisur nga konstatimi i ILDKPKI-së se: “Sipas DPPPP-së⁵³ shoqëria “SH.” sh.p.k., ka raportuar pagesën e kryer nga znj. Bernina Kondi në shumën 5.000.000 lekë, dhe jo pagesën totale prej 8.200.000 lekësh, gjithashtu raportimi i shoqërisë se pagesa është kryer në nr. e llogarisë në BKT, nuk është raportuar nga kjo bankë në DPPPP, çka krijon dyshime për veprimet e kryera.”

2.7.ii Komisioni ka mbajtur korrespondencë me BKT-në⁵⁴ me qëllim konfirmimin e kryerjes së pagesës në shumën 5.000.000 lekë në nr. e llogarisë në BKT, nga ku rezulton se kjo e fundit ka konfirmuar shprehimisht se “Nga verifikimet e kryera, lëvizjeve të llogarisë me nr. (***) të subjektit “SH.” sh.p.k., në datën 3.10.2011, nuk rezulton të jetë kryer ndonjë transaksion, depozitim cash në vlerën 5.000.000 lekë.”

2.8 Subjekti ka deklaruar në deklaratën “Vetting” si burim krijimi për këtë pasuri:

- a) kredinë e marrë nga BKT-ja me afat 25-vjeçar, në shumën 5.000.000 lekë; dhe
- b) kursimet familjare.

2.9 Komisioni hetoi mbi çdo burim krijimi të kësaj pasurie, për të konstatuar ligjshmërinë e tyre, si dhe mundësinë financiare të subjektit.

a) Në lidhje me kredinë e marrë nga BKT-ja në shumën 5.000.000 lekë

2.9.i Nga aktet e administruara, kjo kredi konfirmohet me anë të:

- Kontratës së kredisë⁵⁵ bankare nr. (***), datë 19.07.2011, me palë kredimarrëse shtetasen Bernina Kondi dhe dorëzanës shtetasit E. K., B. Kondi dhe M. K..

⁵² Pyetësor nr. 2, datë 16.12.2019.

⁵³ Referojuni Aneksit nr. 39, në dosjen e ILDKPKI-së.

⁵⁴ Referojuni shkresës nr. (***) prot., datë 17.1.2020, në dosjen e Komisionit.

⁵⁵ Aneks 37 në dosjen e ILDKPKI-së.

- Kontratës së hipotekimit⁵⁶ nr. (***) , datë 19.07.2011, hipotekues shtetasi B. K., e pranishme në nënshkrim, me cilësinë e bashkëshortes së hipotekuesit, e cila shpreh miratimin e saj, znj. M. K. . Hipotekuesi ka vendosur në barrë hipotekore pasuritë e llojit:
 - truall dhe ndërtesë 2-katëshe me sipërfaqe trualli 300 m² dhe sipërfaqe ndërtesë kati i me sip. 100 m² dhe kati (***) me sip. 61 m²;
 - arë me sip. 3.850 m².

2.9.ii Sipas nenit 1 të kontratës së kredisë, palët kanë rënë paraprakisht dakord për nënshkrimin e saj, në bazë: të nenit 1031 e në vazhdim dhe të nenit 560 e në vazhdim të Kodit Civil, të ligjit nr. (***) , datë 13.5.2004, “Për programet sociale të strehimit për banorët e zonave urbane” i ndryshuar; VKM-së nr. 600, datë 12.9.2007, “Për trajtimin me strehim të nëpunësve civilë të administratës së lartë shtetërore dhe funksionarëve politik”; Udhëzimit nr. 6257, datë 2.9.2008, “Mbi përcaktimin e masës së subvencionit për familjet që përfitojnë kredi të lehtësuara nga shteti”, si dhe Udhëzimit të Përbashkët nr. 10240/1, datë 17.10.2008, “Mbi përcaktimin e masës së subvencionit për familjet që përfitojnë kredi të lehtësuara nga shteti”, të Ministrisë së Punëve Publike, Transportit e Telekomunikacionit dhe Ministrisë së Financave; marrëveshjes tripalëshe datë 18.2.2009 dhe çdo marrëveshje tjetër nënshkruar mes palëve në lidhje me këtë objekt; si dhe legjislacionit në fuqi të Republikës së Shqipërisë.

2.9.iii Komisioni konstaton se bazuar në aktet ligjore dhe nënligjore kjo kredi është marrë me kushte lehtësuese dhe subjekti për të ka paguar interes në masën 4 %.

2.9.iv Rezulton se kredia është disbursuar në datën 21.07.2011 dhe në datën 22.07.2011 shuma 4.900.000 lekë është transferuar në favor të shtetasit J. T., me përshkrimin “pagesë për blerje apartamenti me nr. kontratë (***) , datë 27.05.2011”.

2.9.v Në deklaratën periodike vjetore të vitit 2011 subjekti ka deklaruar: *Kontratë porosie (sipërmarrje) me nr. (***) , datë 27.5.2011, për blerjen e apartamentit me sip. 114.5 m² në Berat. Çmimi: 6.000.000 lekë. Likuiduar nga porositësi në fillim shuma prej 1.000.000 lekësh, ndërsa pjesa e mbetur e detyrimit (shuma prej 5.000.000 lekësh) është paguar nga kredia në BKT në shumën 5.000.000 lekë e marrë nga porositësi.*

2.9.vi Më tej, sipas deklaratës noteriale nr. (***) , datë 16.9.2011 (rreth katër muaj pas nënshkrimit të kontratës së porosisë dhe rreth 2 muaj pas lëvrimit të kredisë), është revokuar kontrata e porosisë së sipërcituar nr. (***) , datë 27.5.2011.

2.9.vii Subjekti është pyetur⁵⁷ mbi likuidimin e vlerës së kësaj pasurie nisur nga parashikimet kontraktore, si dhe lidhur me kthimin e shumave të paguara, meqenëse kontrata ishte revokuar. Në vijim, subjekti ka depozituar dokumentacionin justifikues të pasqyruar në tabelën si më poshtë vijon:

Tabela nr. 5

Data	Vlera	Dokumentacioni
27.05.2011	1,000,000	Depozitim <i>cash</i> në BKT për z. J. T.
20.06.2011	250,000	Depozitim <i>cash</i> në BKT për z. J. T.
22.07.2011	4,900,000	Transfertë në BKT për z. J. T.

⁵⁶ Aneks 4/6 në dosjen e ILDKPKI-së.

⁵⁷ Pyetësori nr. 2 datë 16.12.2019.

	6,150,000	
--	------------------	--

2.9.viii Subjekti, për kthimin e shumave të paguara, ka depozituar mandatpagesën nr. (***) , datë 16.9.2011, në shumën 6.150.000 lekë, me përshkrimin “kthim shume për prishje kontrate blerje apartamenti sipas deklaratës noteriale nr. (***) , datë 16.9.2011”.

➤ **Në lidhje me ligjshmërinë e përfitimit të kësaj kredie**

2.9.ix Komisionit, nga verifikimi i dokumentacionit të administruar në dosjen e hetimit administrativ, i ka rezultuar se subjekti ka përfituar kredinë në shumën 5.000.000 lekë me kushte lehtësuese, bazuar në VKM-në nr.600, datë 12.9.2007, “Për trajtimin me strehim të nëpunësve civilë të administratës së lartë shtetërore dhe të funksionarëve politikë”.

2.9.x Sipas parashikimeve të këtij akti nënligjor këto kredi mundësohen për disa kategori, ndër të cilët përfshihen edhe gjyqtarët. Akti nënligjor ka parashikuar se rrethit të përfituesve kur kanë nevojë për strehim ose sipërfaqe banimi shtesë, u lind e drejta të kërkojnë trajtim me kredi me kushte lehtësuese nga shteti, për blerje banese apo sipërfaqe shtesë banimi, në vendin e ushtrimit të detyrës, që, në kuptim të këtij vendimi nënkupton territorin e rrethit, ku ndodhet selia administrative e organit, ku subjekti kryen funksionin ose ushtron detyrën.

2.9.xi Akti nënligjor ka përcaktuar se aplikuesi duhet të paraqesë kërkesën me shkrim pranë titullarit të institucionit ku ushtron detyrën, të shoqëruar me: (a) certifikatën e përbërjes familjare në çastin e dorëzimit të kërkesës; (b) deklaratën për rrethanat, që mbështesin nevojën për strehim dhe për çdo deklaram – për të përfituar nga kredia lehtësuese subjekti konfirmon vërtetësinë e tyre dhe pranon kushtin për konvertimin e drejtpërdrejtë të kredisë lehtësuese në kredi tregtare, kur vërtetohen pavërtetësi në deklaram dhe/ose rrethana të rreme. Në këto raste VKM-ja ka parashikuar si penalitet se, kur gjatë apo pas zbatimit të kredisë rezultojnë se në kërkesë janë bërë deklarime të rreme, kredia konvertohet drejtpërdrejt në kredi tregtare, kusht i përcaktuar edhe në kontratën e kredisë dhe se në këtë rast institucioni bankar është i detyruar që diferencat e dhëna nga buxheti i shtetit për kreditë, të cilat konvertohen në kredi tregtare, t’ia kthejë përsëri buxhetit.

2.9.xii Nga të dhënat e administruara rezulton se subjekti deri në datën 16.7.2013 ka qenë me funksion gjyqtare dhe së fundmi kryetare e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Berat.

2.9.xiii Në këtë kuptim, subjekti i rivlerësimit për shkak të ushtrimit të detyrës në qytetin e Beratit është kthyer në përfitues i kësaj kredie. Për pasojë, detyrimi parësor që subjekti duhet të përmbushte në plotësim të kriterëve të këtij akti nënligjor kishte të bënte me provueshmërinë e faktit se nuk kishte një tjetër banesë në qytetin e Beratit. Ky fakt është provuar dhe, si rrjedhojë, është mundësuar edhe marrja dhe disbursimi i kredisë.

2.9.xiv Në përmbushje të destinacionit/qëllimit të marrjes së kredisë, me kontratën e porosisë nr. (***) , datë 27.5.2011, subjekti i rivlerësimit ka porositur apartament me sip. 114.5 m², në vlerën 6.000.000 lekë, me adresë: lagjja “(***)”, Berat. Lidhur me shlyerjen e vlerës kontrata citon shprehimisht: “... me nënshkrimin e kontratës është paguar vlera 1.000.000 lekë dhe kësti i fundit prej 5.000.000 lekësh do të shlyhet me marrjen e kredisë.”

2.9.xv Sipas *statement*-it të BKT-së kredia është disbursuar në llogarinë e subjektit të rivlerësimit në datën 21.7.2011, në vlerën 4.950.000 lekë, dhe në datën 22.7.2011 shuma prej 4.900.000 lekësh i ka kaluar shtetasit J. L. T. për blerje apartamenti.

2.9.xvi Më tej, subjekti, megjithëse ka vijuar të ushtrojë detyrën në qytetin e Beratit, ka revokuar⁵⁸ kontratën e porosisë dhe shumën e përfituar e ka deklaruar se e ka përdorur si burim krijimi për pasurinë e blerë në qytetin e Tiranës, sipas aktmarrëveshjes datë 1.10.2011, lidhur midis shoqërisë “SH.” sh.p.k., me cilësinë e palës shitëse dhe subjektit të rivlerësimit dhe bashkëshortit të saj, me cilësinë e palës porositëse, për apartament me sip. 90.12 m², në vlerën 8.200.000 lekë, ku citohet se me firmosjen e kontratës paguhet vlera 5.000.000 lekë dhe mbetja e vlerës prej 3.200.000 lekësh do të paguhet në tetor dhe nëntor të vitit 2011.

2.9.xvii Në analizë të akteve të administruara duket se kontrata e porosisë nr. (***) datë 27.5.2011, për blerjen e apartamentit me sip. 114.5 m² në qytetin e Beratit është fiktive dhe e bërë me qëllim përfitimin e kredisë me kushte lehtësuese nga shteti në shumën 5.000.000 lekë, kjo pasi për një periudhë 4-mujore kjo kontratë është revokuar dhe nuk është blerë apartament i ri në qytetin e Beratit ku subjekti vijonte të ushtronte funksionin sipas kushteve të VKM-së, por është blerë apartamenti me sip. 90.12 m², në qytetin e Tiranës, duke përdorur si burim edhe kredinë e marrë në shumën 5.000.000 lekë.

2.9.xviii Komisioni ka vërejtur se transaksionet e shumës 6.000.000 lekë, paguar më parë për llogari të kontratës së porosisë për apartamentin në qytetin e Beratit, pas revokimit të kontratës dhe kthimit të palëve në gjendjen e mëparshme, janë bërë *cash*.

2.9.xix Në tërësi, për këtë çështje të hetuar, në këndvështrim të kriterëve dhe detyrimeve ligjore të zbatueshme në përfitimin e kredive lehtësuese dhe veprimeve të kryera nga subjekti i rivlerësimit, Komisionit i ka rezultuar se nga dokumentacioni i administruar në dosjen e hetimit administrativ subjekti i rivlerësimit duket se ka vepruar në keqbesim, duke ndryshuar destinacionin e kredisë.

2.9.xx Në analizë të fakteve dhe provave të administruara Komisioni ka konstatuar se: (i) dukej se kredia e përfituar në shumën 5.000.000 lekë me kushte lehtësuese kishte ndryshuar destinacionin dhe qëllimin për të cilin ishte përfituar, në tejkalim të parashikimeve ligjore; (ii) dukej se subjekti kishte kryer veprime fiktive me qëllim përfitimin e kredisë me kushte lehtësuese dhe, për pasojë, subjektit iu kalua barra e provës⁵⁹ për të provuar të kundërtën e këtyre konstatimeve.

b) Në lidhje me burimin tjetër të krijimit të kësaj pasurie, kursimet familjare

2.9.xxi Në deklaratën periodike vjetore të vitit 2009 bashkëshorti i subjektit deklaroi të ardhura *cash* në shumën 2.500.000 lekë, si të ardhura në vite që nga deklarimi i parë deri në datën 31.12.2009.

2.9.xxii Ndërsa, në deklaratën periodike vjetore të vitit 2010 subjekti deklaroi shtesë kursimesh nga paga e saj vjetore në shumën 500.000 lekë dhe shtesë kursimesh nga paga vjetore e bashkëshortit në shumën 500.000 lekë. Pra, në total shtesa e këtij viti ka qenë në shumën 1.000.000 lekë.

2.9.xxiii Si rezultat i këtyre shtesave gjendja *cash* në fund të vitit 2010 rezulton të jetë në shumën 3.500.000 lekë, shumë kjo nga e cila 3.200.000 lekë janë përdorur për të paguar kështet e apartamentit në rrugën “(***)”, Tiranë. Për këtë vit Komisioni e ka pasqyruar analizën financiare në tabelën nr. 3, ku subjekti ka rezultuar të jetë në pamundësi financiare.

⁵⁸ Me deklaratën noteriale nr. (***) datë 16.9.2011, ku shtetasi J. T. dhe subjekti i rivlerësimit, me pëlqimin dhe vullnetin e tyre kanë deklaruar zgjidhjen e kontratës nr. (***) datë 27.5.2011, duke mos pasur asnjë pretendim për kryerjen e veprimit juridik.

⁵⁹ Bazuar në nenin 52, të ligjit nr. 84/2016 dhe paragrafit 3 dhe 5, të nenit D, të Aneksit të Kushtetutës.

2.9.xxiv Komisioni hetoi mbi mundësinë financiare të bashkëshortit të subjektit, i cili është gjithashtu subjekt deklarues, nëse kishte mundësi të krijonte shumën 2.500.000 lekë deri në vitin 2009.

2.9.xxv Nga analiza vihet re se bashkëshorti i subjektit në deklarimet e tij periodike shton në mënyrë të vazhdueshme gjendjen *cash*. Gjithashtu, nga hetimi administrativ dhe konfirmimi bankar duket se bashkëshorti i subjektit investon në depozita, por në deklaratat periodike këto depozita nuk janë deklaruar.

Gjendja akumulative e gjendjes *cash* ka rezultuar si më poshtë vijon:

Tabela nr. 6

Viti	2003	2004	2005	2006	2007	2008	2009
Përshkrimi	Të holla në banesë, të ardhura personale dhe të familjes	Gjendja <i>cash</i> 6.000 USD, shtesa 2.000 USD	Gjendja <i>cash</i> 10.000 USD, shtesa 4.000 USD	Shtuar për vitin 2006, 3.000 USD	Shtuar 6.000 USD	Kursime nga paga ime për vitin 2008, 7.000 USD	215.000 lekë <i>cash</i> , të ardhura nga paga
Shtesa / pakësim	4.000 USD	2.000 USD	4.000 USD	3.000 USD	6.000 USD	7.000 USD	215.000 lekë
Gjendja akumulative në USD		6.000 USD	10.000 USD	13.000 USD	19.000 USD	26.000 USD	26.000 USD + 215.000 lekë
Vlera totale në lekë	434.760	567.480	1.033.300	1.217.736	1.577.570	2.364.960	2.579.960

Ndërsa, depozitat rezultojnë si më poshtë vijon:

Banka	Produkti	Viti 2006 Vlera në valutë	Viti 2007 Vlera në valutë	Viti 2008 Vlera në valutë
ABI	depozitë	9.950 euro	10.276,67 euro	10.662,82 euro
Raiffeisen Bank	depozitë			10.000 USD
Raiffeisen Bank	llogari e lidhur me depozitën			- 8.000 USD

2.9.xxvi Në analizë të deklarimeve të subjektit, fakteve dhe provave të rezultuara gjatë hetimit, si dhe përlogaritjeve financiare, Komisioni i kaloi subjektit barrën e provës⁶⁰ se: (i) dukej se bashkëshorti i saj nuk kishte pasur mundësi të shtojë gjendjen e tij të likuiditeteve në vitet 2006 dhe 2008, si dhe të përballojë shpenzimet e tjera në shumën 1.030.309 lekë; (ii) dukej se nuk provohej burimi i ligjshëm i krijimit të shumës 1.030.309 lekë.

Qëndrimi i subjektit në lidhje me faktet e konstatuara nga Komisioni

2.10 Në lidhje me konstatimet mbi ligjshmërinë e kredisë në shumën 5.000.000 lekë me kushte lehtësuese subjekti ka parashtruar se nga viti 2004 - 2008 ka ushtruar detyrën e gjyqtares në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Berat dhe nga prilli i vitit 2008 deri në datën 16.7.2013 ka ushtruar detyrën e kryetares së kësaj gjykate. Në këtë kuptim, për shkak të ushtrimit të detyrës në qytetin e Beratit ka përfituar kredinë. Subjekti është shprehur se për pasojë detyrimi parësor që duhet

⁶⁰ Bazuar në nenin 52, të ligjit nr. 84/2016, dhe paragrafit 3 dhe 5, të nenit D, të Aneksit të Kushtetutës.

të përmbushte në plotësim të kriterëve të aktit nënligjor kishte të bënte me provueshmërinë e faktit se nuk kishte një tjetër banesë në qytetin e Beratit. Ky fakt është provuar dhe, si rrjedhojë, është mundësuar marrja dhe disbursimi i kredisë.

Subjekti ka cituar legjislacionin e përmendur edhe në veprimet kontraktore të përfitimit të kredisë së butë. Po ashtu, ka cituar parashikimet e aktit nënligjor se çfarë duhet të paraqesë aplikuesi për të përfituar në këto raste. Subjekti ka sqaruar se kërkesa për kredi të butë është vlerësuar dhe aprovuar nga dy institucione: Gjykata e Lartë dhe BKT-ja, të cilat kishin kompetencën dhe detyrimin që të verifikonin plotësimin ose jo të kriterëve të parashikuara nga VKM-ja, nr. 600, datë 12.9.2007, “Për trajtimin me strehim të nëpunësve civilë të administratës së lartë shtetërore dhe funksionarëve politik”, nga ana e kërkuësve, përpara se të kalonin kredinë në favor të tyre. Subjekti, ndër të tjera, ka cituar se apartamenti që zotëronte në Tiranë në rrugën “(***)” rezultonte me sip. 57 m², duke llogaritur edhe korridorin, ballkonin, tualetin dhe mjediset ndihmëse dhe po t’i zbriten këto sipërfaqe, në total, është shprehur subjekti, mbeten gati 40 m². Subjekti i është referuar interpretimit të germës “a”, të pikës 5, të VKM-së, nr. 600/2007, ku citohet: “Për strehim: kur ka 50 m² sipërfaqe banimi, subjekti i martuar ...në sipërfaqen e banimit nuk përfshihen korridoret, ëc-ja, ballkonet, tarraca, dhe mjediset e tjera ndihmëse, të tilla si depot apo shesh pushimet”, duke vijuar të sqarojë se edhe në qytetin e Tiranës konsideroheshin në kuptim të përcaktimit ligjor të sipërcituar, si familje në nevojë për strehim, pasi i përmbushnin kriteret ligjore. Në këtë kontekst, subjekti ka shpjeguar se blerja e apartamentit në Tiranë është kryer duke qenë në përputhje me parashikimet ligjore dhe jo në shkelje të tyre. Po ashtu, ka sqaruar se në periudhën që kishte aplikuar për kredi të butë familja e saj përbëhej nga tri persona, prej saj, bashkëshortit dhe vajzës së madhe Rezalinda dhe se ishin në pritje të fëmijës së dytë. Nën këto argumente subjekti ka pretenduar se përsëri konsiderohej se i plotësonte kriteret për përfitimin e kredisë së butë. Subjekti ka cituar edhe disa vendime të Komisionit, duke pretenduar se përbëjnë raste të ngjashme, sikurse dhe rasti i saj, dhe se kreditë janë konsideruar të ligjshme.

Subjekti ka kundërshtuar faktin se janë kryer veprime fiktive për përfitimin e kredisë, për sa i përket veprimeve juridike të kryera prej saj, pasi shuma prej 5.000.000 lekësh e marrë nëpërmjet kredisë së butë fillimisht është përdorur për qëllimin e paracaktuar në kontratën e kredisë në fjalë, pra, për blerjen e apartamentit në Berat, sipas kushteve të përcaktuara në marrëveshjen e bërë me BKT-në dhe se pas revokimit të kontratës së porosisë nr. (***) , datë 27.5.2011, sipas deklaratës noteriale nr. (***) , datë 16.9.2011 – në mungesë të një dispozite shtrënguese për të kthyer pas shumën e marrë nga kredia, është vendosur përdorimi i saj për blerjen e një tjetër apartamenti. Subjekti ka sqaruar se edhe në qoftë se mund të ketë fushë interpretimi lidhur me mundësinë e kthimit pas të shumës në bankën që kishte dhënë kredinë, mungon një parashikim detyrues në këtë drejtim. Për rrjedhojë, subjekti është shprehur se nuk ka prova të mjaftueshme për të konkluduar se prej saj ka pasur një përfitimin të kredisë së butë, në kundërshtim të qartë me dispozitat normative në fuqi, apo ndonjë fiktivitet kontraktor i kryer prej tyre.

2.11 Në lidhje me pagesat e bëra në *cash* subjekti ka sqaruar se koha e mbajtjes së tyre në këtë gjendje ka qenë një muaj dhe ky afat i është dashur për të gjetur banesën në treg, vendin, çmimin etj. Subjekti shpjeguar se ka vazhduar të kërkojë nëpërmjet agjencive imobiliare dhe agjentëve të ndryshëm të shitjeve, për objekt “apartament” në zona dhe objekte të ndryshme të Tiranës. Përsëri subjekti ka cituar vendime të Komisionit mbi trajtimin e të njëjtave problematika të ngritura mbi përfitimin e kredisë së butë, si në rastin e saj lidhur me shumën e disponuar *cash*.

2.12 Në lidhje me konstatimin e Komisionit se dukej se bashkëshorti i subjektit nuk kishte pasur mundësi të shtojë gjendjen e tij të likuiditeteve në vitet 2006 dhe 2008, si dhe të përballojë

shpenzimet e tjera në shumën 1.030.309 lekë, dukej se nuk provohej burimi i ligjshëm i krijimit të kësaj shume. Subjekti, ndër të tjera, ka parashtruar se: në deklarin e bashkëshortit për vitin 2005, në lidhje me mjetet monetare është deklaruar vlera prej 10.000 USD, gjendje *cash* prej tij, në fund të vitit 2005; në deklarin e vitit 2006, është deklaruar për vitin 2006 shtesa prej 3.000 USD, në krahasim me vitin e mëparshëm 2005 në të cilin ishte akumuluar gjendja prej 10.000 USD dhe nuk është përcaktuar se këto shuma, pra, vlera totale prej 13.000 USD gjendeshin në *cash*, kur ndërkohë bashkëshorti shumën prej 9.950 euro të konvertuar nga vlera e dollarëve të akumuluar 10.000 USD deri në vitin 2005, së bashku me një pjesë të vlerës së kursyer nga pagat gjatë vitit 2006, e kishte kaluar gjatë këtij viti në depozitë në ABI, e cila është afërsisht ekuivalente në shumën 13.000 USD. Pra, vlera e depozitës është krijuar nga gjendja *cash* e mbartur deri në fund të vitit 2005, si dhe nga kursimet e vitit 2006. Po ashtu, subjekti ka cilësuar se periudha gjatë të cilave është konstatuar mosmbulim shpenzimesh nga bashkëshorti i saj për vitet 2006 dhe 2008, nuk ka qenë e martuar dhe se ai është vetë subjekt rivlerësimi dhe do të japë shpjegime për këto gjetje gjatë hetimit administrativ që do të kryhet ndaj tij.

Arsyetimi ligjor dhe analiza e provave në raport me faktet dhe me ligjin e zbatueshëm

Në rastin objekt gjykimi, trupi gjykues, në analizë të të gjitha fakteve dhe konkluzioneve të arritura, arsyeton si vijon:

2.13 Në lidhje me veprimet juridike të kryera nga subjekti, konkretisht, në lidhje me:

i) nënshkrimin e kontratës së porosisë (sipërmarrjes) nr. (***) , datë 27.5.2011, për blerjen e apartamentit me sip. 114.5 m² në Berat, me çmim 6.000.000 lekë, likuiduar nga porositësi, në fillim shuma prej 1.000.000 lekësh, ndërsa, pjesa e mbetur e detyrimit (shuma prej 5.000.000 lekësh) paguar nga kredia në BKT në shumën 5.000.000 lekë, dhe

ii) nënshkrimin e deklaratës noteriale nr. (***) , datë 16.9.2011 (rreth katër muaj pas nënshkrimit të kontratës së porosisë dhe rreth 2 muaj pas lëvrimit të kredisë), me të cilën është revokuar kjo kontratë,

trupi gjykues çmon se është shprehur vullneti i palëve dhe për sa kohë ato nuk janë bërë objekt gjyqësor, nuk mund të trajtohen si veprime fiktive. Trupi gjykues vlerëson të arsyetojë në këtë vendim, mënyrën se si janë ndjekur veprimet në raport me qëllimin e përdorimit të kredisë. Në këtë kontekst, verifikimi i qëllimit, nëse është në përputhje me vetë atë dhe normat ligjore që parashikojnë përfitimin e kredive në të cilin është përfshirë subjekti, është një proces i cili duhet të jetë pjesë e verifikimeve që kryhen në kuadër të procesit të rivlerësimit, në zbatim të detyrimit kushtetues që ka subjekti i rivlerësimit, sipas parashikimit të pikës 1, të nenit D, të Aneksit të Kushtetutës, për të provuar burimin e ligjshëm të pasurive të tij.

Më konkretisht, konstatohet se subjekti i rivlerësimit ka përfituar kredinë e butë pikërisht se nuk ka pasur një banesë në qytetin e Beratit ku ushtronte detyrën. Rezulton se subjekti, megjithëse veprimet juridike i ka kryer në vitin 2011 dhe se po në këtë vit ka fituar edhe pasurinë në Tiranë, përsëri ka vijuar edhe për dy vite të tjera të ushtronte detyrën në Berat, më saktësisht, deri në datën 4.11.2013, kohë edhe kur është emëruar në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë. Pra, ajo që kuptohet është fakti se ndërsa kredia u transferua në një qytet tjetër, subjekti nuk ndryshoi qytetin ku ushtronte detyrën dhe për këtë shkak përfitoi edhe kredinë. Për më tepër, nuk shihet nevoja e kësaj banese në Tiranë, pasi subjekti në parashtrimet e saj mbi balancën negative të konstatuar në vitin 2012 (shihni qëndrimin e subjektit në pikën 9 të këtij vendimi) sqaron se *kjo shtëpi është blere në muajin tetor 2011 dhe ka filluar të banohet në fundin e vitit 2012.*

Po ashtu, ngutshmëria e kryerjes së veprimeve juridike nuk përputhet me nevojën ekstreme për të pasur një banesë në Tiranë, pasi një të tillë subjekti e kishte në zotërim, por në mënyrë të

drejtpërdrejtë përputhet me nevojën që subjekti kishte për të pasur një banesë në Berat edhe për dy vite të tjera.

Pretendimi i subjektit se mungesa e një dispozite shtrënguese nga banka kishte lejuar në një farë mënyrë edhe kryerjen e transferimit të kredisë, nuk qëndron, për sa kohë legjislacioni paraprakisht kërkon qartazi që kusht kryesor për përfitimin e kësaj kredie është deklarimi me vërtetësi i mospasjes së një banese në vendin e ushtrimit të detyrës.

Të gjithë këto argumente, duke u ndërthurur edhe me transaksione të kryera në *cash* për pagimin e kësteve, trupi gjykues i vlerëson se nuk mbështesin në kontekstin administrativ kryerjen e veprimeve të rregullta ligjore dhe as përputhen me qëllimin real të marrjes së kredisë.

Po ashtu, trupi gjykues vlerëson se edhe pretendimi tjetër i subjektit se, edhe nëse konsiderohej se kishte një banesë në Tiranë ajo nuk ishte në normën e kërkuar nga VKM-ja nr. 600/2007, pasi ishte gati 40 m² dhe se sipas germës “a”, të pikës 5, të këtij akti nënligjor, lejohej strehimi në rastet kur ka 50 m² sipërfaqe banimi, subjekti i martuar ...në sipërfaqen e banimit nuk përfshihen korridoret, Wc-ja, ballkonet, tarraca, dhe mjediset e tjera ndihmëse, të tilla si *depot apo shesh pushimet*” – nuk qëndron, për sa kohë subjekti nuk kishte aplikuar me këtë formë kërkimi, apo, për më tepër, kur nuk e ka përdorur apartamentin e blerë nëpërmjet saj për një vit.

- ✓ Në konkluzion të arsyetimit të mësipërm, trupi gjykues çmon se veprimet juridike të kryera nga subjekti i rivlerësimit në funksion të përfitimit të një kredie me kushte lehtësuese për të financuar blerjen e një banese tjetër në Tiranë, që, nga hetimi administrativ subjekti rezulton t'i ketë në pronësi të tij, janë kryer në tejkalim të parashikimeve ligjore mbi përfitimin e kredisë.

2.14 Ndërsa, në lidhje me balancat negative të konstatuara ndaj bashkëshortit të subjektit për vitet 2006 – 2008, Komisioni është prirur të krijojë një panoramë të plotë të provueshmërisë së burimit të ligjshëm të shumës 3.200.000 lekë, si këst i paguar për këtë pasuri, shumë në të cilën është përfshirë edhe gjendja *cash* e ardhur nga bashkëshorti i subjektit në shumën 2.500.000 lekë. Komisioni padyshim ka pasur në vëmendje faktin se kjo shumë është krijuar para martese dhe në këtë kontekst ka mbajtur në konsideratë dhe e ka përfshirë në analizën financiare këtë shumë. Pra, konstatimi është përcjellë te subjekti si një faktor evident që duhet provuar dhe, për më tepër, se nga hetimi administrativ dhe konfirmimi bankar dukej se bashkëshorti i subjektit investonte në depozita, por në deklaratat periodike këto depozita nuk janë deklaruar⁶¹. Subjekti ka parashtruar dhe depozituar dokumentacion mbështetës.

- ✓ Trupi gjykues, në analizë të shpjegimeve të subjektit dhe në konsideratë të fakteve se **a)** të ardhurat e bashkëshortit janë krijuar përpara lidhjes bashkëshortore, **b)** bashkëshorti i subjektit është pjesë e procesit të rivlerësimit nga një tjetër trup gjykues, çmon se nuk mund të arrihet në një konkluzion që ndikon në këtë vendimmarrje.

3. Në lidhje me pasuritë të paluajtshme (toka)⁶²

Subjekti, në deklaratën “Vetting”, ka deklaruar:

3.1 Truall me sip. 300 m², nga kjo 100 m² ndërtesë, ndodhur në V., Berat. Viti i krijimit 1977, ndërtuar nga prindërit e saj, regjistruar në ZRPP-në Berat. Pjesa takuese: ¼ pjesë.

⁶¹ Shihni përgjigjet e dhëna në procesverbalin e mbajtur në ILDKPKI në vitin 2012, në dosjen e Komisionit.

⁶² Aneks 4/4 në dosjen e ILDKPKI-së.

3.2 Pasuri e llojit arë, me sip. 2.400 m², ndodhur në V., Berat, përfitur me ligjin nr. 7501 “Për tokën”, regjistruar në ZRPP Berat. Pjesa takuese: ¼ pjesë.

3.3 Pasuri e llojit arë, me sip. 3.850 m², ndodhur në V., Berat, përfitur me ligjin nr. 7501 “Për tokën”, regjistruar në ZRPP Berat. Pjesa takuese: ¼ pjesë.

3.4 Pasuri e llojit ullishte, me sip. 275 m², ndodhur në V., Berat, përfitur me ligjin nr. 7501 “Për tokën”, regjistruar në ZRPP Berat. Pjesa takuese: ¼ pjesë. Për shkak të ndërrimit të jetës së nënës së subjektit, si bashkëpronare në këto pasuri, pjesa e saj takuese prej 1/4 do të ndahet në tri pjesë, bashkëshorti i saj dhe dy fëmijët. Pjesa takuese: ¾ pjesë. Subjekti i ka bashkëlidhur deklaratës disa dokumente⁶³.

3.5 ILDKPKI-ja, në raportin e saj, ka konstatuar se deklarimi i subjektit përputhet me dokumentacionin e paraqitur.

- ✓ Nga verifikimi i dokumentacionit trupi gjykues nuk ka konstatuar problematika për vërtetësinë e këtyre deklarimeve pronësore në emër e për llogari të babait të subjektit të rivlerësimit.

➤ **Detyrimet financiare**

4. Në lidhje me kredinë bankare në “Bankën Kombëtare Tregtare” sh.a., dega (***), lidhur në datën 19.7.2011, shuma 5.000.000 lekë, me afat 25 vjet, nr. i kontratës (***), me interes 4 %, këste shlyerjeje një mujore, vlera e kështit 27.000 lekë. Qëllimi i detyrimit financiar ishte blerja e apartamentit në rrugën “(***), i deklaruar më sipër. Shuma e detyrimit: 4.334.061 lekë.

Nga korrespondenca institucionale, BKT-ja, me shkresën nr. (***) prot., datë 5.11.2019, konfirmon se subjekti disponon kredi me gjendje detyrimi në datën 26.1.2017, me vlerë 4.282.066 lekë.

- ✓ Trupi gjykues konstaton se ndryshimi midis gjendjes së deklaruar dhe asaj të konfirmuar ka ndodhur për shkak të paraqitjes së dokumentacionit bankar në datën 12.10.2016 dhe datës së dorëzimit të deklaratës 26.1.2017 dhe, për pasojë, nuk vërehen problematika lidhur me këtë deklaram.

5. Në lidhje me kontratën e huadhënies me nr(***), datë 2.4.2010, lidhur para noterit, shuma 1.200.000 lekë. Qëllimi i detyrimit financiar ishte shlyerja e plotë e kredisë marrë në “Alpha Bank” në datën 7.7.2005, në vlerën 2.500.000 lekë, shlyerja e plotë e kredisë u krye në datën 9.4.2010 (bashkëlidhur kopje e kontratës së huadhënies). Shuma e detyrimit: 1.200.000 lekë.

- ✓ Trupi gjykues e ka trajtuar këtë hua në pasurinë nr. 1 dhe, për pasojë, vlerësohet se nuk është e nevojshme ripërsëritja e arsyetimit.

⁶³ Certifikatë pronësie datë 11.5.2005 + kartelë pasurie + hartë treguese, për truallin me sip. 300 m²; certifikatë pronësie nr. (***), datë 15.4.2011 + kartelë pasurie + hartë treguese, për arën me sip. 2400 m²; certifikatë pronësie nr. (***), datë 15.4.2011 + kartelë pasurie + hartë treguese, për arën 3850 m²; certifikatë pronësie nr. (***), datë 15.4.2011 + kartelë pasurie + hartë treguese, për ullishten me sip. 275 m²; dëshmia e trashëgimisë ligjore nr. (***), datë 28.12.2016 (aneksi nr. 4/4, në dosjen e ILDKPKI-së).

Truall me sip. 300 m², nga kjo 100 m² ndërtesë; pasuri e llojit arë, me sip. 2.400 m²; pasuri e llojit arë, me sip. 3850 m²; pasuri e llojit ullishte, me sip. 275 m², të gjitha këto pasuri të ndodhura në V., Berat. Për shkak të ndërrimit të jetës së nënës së subjektit, si bashkëpronare në këto pasuri, pjesa e saj prej 1/4 do të ndahet në tri pjesë, bashkëshorti i saj dhe dy fëmijët. Pjesa takuese: ¾ pjesë.

GJETJE TË TJERA

6. Komisionit, gjatë hetimit, i rezultoi se subjekti në deklaratën periodike vjetore të vitit 2003 ka deklaruar: *“Automjet tip Benz 2000 me targa (***) , vlera 700.000 lekë, pjesa zotëruese 100 %, burimi i krijimit: të ardhura familjare”*.

Në deklaratën periodike vjetore të vitit 2004 subjekti ka deklaruar këtë pasuri me përshkrim *“makinë tip Benz 2000, me targa (***) , vlera 700.000 lekë, pjesa zotëruese: 100%, viti i krijimit 2003”*.

Në deklaratën periodike vjetore të vitit 2005 subjekti ka deklaruar: *“shitje e autoveturës tip Benz 2000 me targa (***) , vlera e shitjes 600.000 lekë dhe pjesa takuese 100%”*.

Komisionit, gjatë korrespondencës së mbajtur me DPSHTRr-në⁶⁴, i ka rezultuar se subjekti nuk e ka pasur në pronësi këtë automjet dhe pasi ka pyetur⁶⁵ subjektin, ajo ka deklaruar: *“...ky automjet është blerë nga familja ime kur unë kam qenë studente në Fakultetin e Drejtësisë, shumë vite më parë se unë të bëhesha subjekt deklarimi. Deklaroj se unë nuk kam qenë asnjëherë pronare e këtij automjeti. Me këtë automjet familja ime ka pësuar një aksident në vitin 2006, si pasojë automjeti ka dalë jashtë përdorimit dhe pjesët e tij janë shitur në kohë të ndryshme pjesë-pjesë. Saktësoj se deklarimi i këtij automjeti në deklaratën time të parë në ILDKPKI ka qenë për paraqitje korrekte të deklarimeve të mija pasurore, duke plotësuar edhe deklarimin e përdorimit të mjeteve të transportit. Qëllimi i këtij deklarimi ka qenë për të paraqitur këtë mjet transporti të familjes që ndonjëherë edhe unë e kam përdorur”*.

Në procesverbalin e mbajtur në ILDKPKI në datën 6.3.2012, në lidhje me shitjen e këtij automjeti, subjekti ka deklaruar se: *“...nuk e disponon kontratën e shitjes, pasi në vitin 2005 pas bërjes së aksidentit me këtë makinë, e ka dërguar te një pikë servisi(***) , ku është kryer edhe shitja e këtij mjeti. Janë kryer procedurat e çregjistrimit pranë DPSHTRr-së dhe ky automjet nuk figuron në emrin tim.”*

Për sa kohë që ky automjet nuk ka qenë në pronësi të subjektit, si dhe nuk provohet me dokumentacion shitja dhe shuma e përfutur nga kjo shitje, Komisioni nuk i ka përfshirë në analizë të ardhurat nga shitja e këtij automjeti.

Në analizë të këtij arsyetimi, Komisioni ka konstatuar mospërputhje mes deklarimeve të dhëna nga subjekti gjatë hetimit administrativ me deklarimet e dhëna për këtë pasuri në ILDKPKI në datën 6.3.2012 dhe, për pasojë, i kërkuar subjektit të japë shpjegime.

Qëndrimi i subjektit në lidhje me faktet e konstatuara nga Komisioni

Subjekti, në lidhje me këtë konstatim, ka parashtruar se këto mospërputhje duhet të konsiderohen pasaktësi dhe jo rrethana të rreme të pasqyruara prej saj, pasi për asnjë moment nuk kishte fshehur asnjë fakt të ndodhur realisht.

Arsyetimi ligjor dhe analiza e provave në raport me faktet dhe me ligjin e zbatueshëm

Trupi gjykues në analizim të dokumentacionit të administruar, shpjegimeve të dhëna nga subjekti, si dhe faktit që të ardhurat e pretenduara nuk kanë shërbyer si burim për ndonjë pasuri, çmon se mospërputhjet e konstatuara nuk ndikojnë në këtë vendimmarrje.

7. Komisionit i ka rezultuar se subjekti në deklaratën periodike vjetore të vitit 2005 ka deklaruar *“blerje e autoveturës tip ‘Opel Corsa’, prodhim i vitit 1997, vlera 200.000 lekë, pjesa takuese 100 %”*.

⁶⁴ Referojuni shkresës nr. (***) prot., datë 17.10.2019, në dosjen e Komisionit.

⁶⁵ Pyetësor nr. 3 datë 7.1.2020.

Blerja e këtij automjeti është konfirmuar me kontratën e shitblerjes⁶⁶ nr. (***) , datë 20.4.2005.

- Komisioni kreu analizën mbi mundësinë financiare të subjektit për të investuar në këtë pasuri nga ku rezultoi se:

Tabela nr. 7

Nr.	Përshkrimi	01.01 - 20.4.2005
1	TË ARDHURA	257,650
	Të ardhura nga paga, subjekti	257,650
2	SHPENZIME	36,519
	Shpenzime jetese sipas ILDKPKI-së	36,519
3	PASURI	388,941
	Autoveturë Opel Corsa	200,000
	Ndryshim likuiditeti	188,941
	DIFERENCA (1-2-3)	-167,810

Për sa më sipër, dukej se subjekti nuk kishte pasur mundësi financiare në shumën 167.810 lekë për të investuar në blerjen e kësaj pasurie dhe, për pasojë, i kaloi barrën e provës⁶⁷ për të provuar të kundërtën.

Qëndrimi i subjektit në lidhje me faktet e konstatuara nga Komisioni

Subjekti, në parashtrimet e saj, ka kontestuar analizën financiare të kryer nga Komisioni, duke cituar se nuk arrijnë të kuptojnë se si është arritur të saktësohet shtesa e likuiditeteve të subjektit në datën 20.4.2005, në shumën 188.941 lekë, kur deklaratimet e bëra prej saj janë vetëm vjetore, dhe në fund të vitit 2005 ndryshimi i likuiditeteve ka qenë vetëm 10.460 lekë, edhe pse pas datës 20.4.2005 ka bere vetëm shpenzime jetike, kur pagën e ka pasur disa herë më të lartë se këto shpenzime, pra, me të njëjtën analizë, duhet të kursente shumë më tepër se shuma 188.941 lekë, të cilën sipas Komisionit e kishte kursyer tashmë deri në datën 20.4.2005.

Po ashtu, subjekti ka sqaruar se në blerjen e këtij automjeti kanë kontribuar edhe prindërit e saj në vlerën 100.000 lekë dhe për shkak se ata nuk jetojnë më është në pamundësi objektive për të paraqitur deklaratë noteriale nga ana e tyre lidhur me këtë fakt. Subjekti ka depozituar edhe certifikatat e vdekjes së prindërve të saj.

Arsyetimi ligjor dhe analiza e provave në raport me faktet dhe me ligjin e zbatueshëm

Për sa i përket të dhënave të pasqyruara në analizën financiare shuma prej 188.941 lekësh nuk është kursim i subjektit, por diferencë e likuiditeteve nga data 20.4.2005 – 31.12.2004. Duke qenë se subjekti nuk ka pasur gjendje *cash* në fund të vitit 2004, Komisioni ka kryer diferencën vetëm mes likuiditeve në bankë.

Fakti që subjekti pretendon se në krijimin e kësaj pasurie kanë kontribuar edhe prindërit e saj dhe që në mënyrë të drejtpërdrejtë nëpërmjet certifikatave të vdekjeve së tyre, provohet pamundësia e provueshmërisë së këtij deklarami, trupi gjykues vlerëson se ndodhet në kushtet e zbatimit të nenit 32/4, të ligjit nr. 84/2016 dhe, për pasojë, konsideron dhe merr të mirëqenë dhënien e këtij kontributi në shumën e deklaruar 100.000 lekë. Në këtë kontekst, nga rilllogaritjet financiare subjekti rezulton në balancë negative në shumën 67.810 lekë.

⁶⁶ Depozituar nga subjekti në pyetësorin nr. 3, datë 7.1.2020.

⁶⁷ Bazuar në nenin 52, të ligjit nr. 84/2016 dhe paragrafit 3 dhe 5, të nenit D, të Aneksit të Kushtetutës.

- ✓ Në përfundim, bazuar në pikën 3, të nenit 61, të ligjit nr. 84/2016, trupi gjykues konstaton se subjekti i rivlerësimit ka bërë deklaram të pamjaftueshëm në lidhje me burimin e kësaj pasurie, si dhe gjendet në balancë negative në shumën 67.810 lekë për krijimin e saj dhe mbulimin e shpenzimeve deri në prill të vitit 2005, konstatim i cili nuk përbën shkak në këtë vendimmarrje.

8. Nga analiza financiare e kryer, Komisionit i ka rezultuar se subjekti ka qenë në pamundësi financiare në shumën 295.638 lekë për vitin 2012, vit kur subjekti ka paguar doktoraturën në shumën 5.500 euro.

Tabela nr. 8

Nr.	Përshkrimi	2012
1	TË ARDHURA	1,960,546
	Të ardhura nga paga, subjekti	924,182
	Të ardhura nga paga, bashkëshorti	1,036,338
	Të ardhura nga interesat bankare	26
2	SHPENZIME	2,267,487
	Shpenzime jetese sipas ILDKPKI-së	564,096
	Pagesë për studime në fushën e doktoraturës	768,460
	Shpenzime arredimi	480,000
	Shpenzime telefoni	136,452
	Kredi BKT (19.07.2011) (5.000.000 lekë)	318,479
3	PASURI	(11,303)
	Pasuri e paluajtshme/e luajtshme	
	<i>Ndryshim likuiditeti</i>	(11,303)
	DIFERENCA (1-2-3)	-295,638

Në analizë të të dhënave të pasqyruara me zëra në tabelën financiare më sipër është arritur në konkluzion se subjekti gjendet në balancë negative për vitin 2012 dhe, për pasojë, Komisioni i kaloi barrën e provës⁶⁸, pasi dukej se subjekti nuk kishte pasur mundësi financiare në shumën -295.638 lekë për të mbuluar shpenzimet e kryera për këtë vit.

Qëndrimi i subjektit në lidhje me faktet e konstatuara nga Komisioni

Subjekti, në parashtrimet e saj, ka sqaruar se nga analiza e bërë nga Komisioni për arredimin e banesës në të cilën ajo banon në rrugën “(****)” është marrë në konsideratë shpërndarja e shpenzimeve për arredimin e saj në shumën totale 800.000 lekë, nga të cilat për vitin 2012 në masën 60 % në vlerën 480.000 lekë dhe për vitin 2013 në masën 40 % në shumën 320.000 lekë.

Subjekti ka sqaruar se ka deklaruar me herët që kjo banesë është blerë në tetor të vitit 2011 dhe ka filluar të banohet në fund të vitit 2012.

Pasi është blerë në vitin 2011, porositi e para për arredimin e banesës janë bërë për kuzhinën dhe dollapët e gjumit, për të cilat është paguar paraprakisht gjatë dhjetorit të vitit 2011 vlera 300.000 lekë për mobilierin.

Në këto kushte, vlera e shpërndarjes së shpenzimeve për arredimin e banesës duhet të saktësohet, duke kaluar shumën 300.000 lekë në shpenzimet e vitit 2011, dhe për shkak të

⁶⁸ Bazuar në nenin 52, të ligjit nr. 84/2016 dhe paragrafit 3 dhe 5, të nenit D, të Aneksit të Kushtetutës.

vonesës në kalimin në këtë banesë deri në fund të vitit 2012, shpenzimet për arredim të vitit 2012 të përlloragiten në shumën e mbetur prej 180.000 lekësh.

Arsyetimi ligjor dhe analiza e provave në raport me faktet dhe me ligjin e zbatueshëm

Trupi gjykues, në analizë të pretendimeve të subjektit të rivlerësimit, megjithëse konstaton se nuk u depozitua ndonjë dokumentacion justifikues për të provuar shpenzimet e kryera me qëllim saktësimin e tyre, sikurse kërkon subjekti, vlerëson të rikonfirmojë të njëjtën ndarje të shpenzimeve të arredimit siç janë pasqyruar në rezultatet e dërguara subjektit. Kjo, jo vetëm për faktin se subjekti nuk depozitoi asnjë dokumentacion provues, por edhe sepse gjatë hetimit administrativ subjekti është pyetur disa herë nga Komisioni dhe në përgjigjet e dhëna nuk ka kryer ndonjë ndarje të këtyre shpenzimeve, por e ka deklaruar shumën e shpenzuar në total.

Në kushte të tilla, duke mos e marrë në konsideratë pretendimin e subjektit për shpenzimet e arredimit, por duke rilogaritur shpenzimet telefonike (të trajtuara në pikën 1.18.xxiii), balanca negative për vitin 2012 rezulton në shumën 203.615 lekë.

Në këto kushte, trupi gjykues konstaton se:

- ✓ Subjekti gjendet në balancë negative në shumën 203.615 lekë për të mbuluar shpenzimet e detajuara në tabelën nr. 8.

9. Në lidhje me derdhjen e shumës 101.000 lekë në llogarinë e kredisë në “Alpha Bank”

Komisionit, nga verifikimi i *statement*⁶⁹ të llogarisë së kredisë, të përcjellë nga “Alpha Bank”, i ka rezultuar se subjekti ka kryer një derdhje në shumën 101.000 lekë në datën 11.1.2006.

Në deklaratën periodike vjetore te vitin 2005 subjekti nuk ka deklaruar gjendje *cash*.

Mbi këto konstatime Komisioni ka konkluduar se dukej se subjekti nuk kishte pasur mundësi financiare për të krijuar brenda 11 ditëve shumën 101.000 lekë dhe, për pasojë, i kaloi barrën e provës⁷⁰.

Qëndrimi i subjektit në lidhje me faktet e konstatuara nga Komisioni

Subjekti, në parashtrimet e saj, ka kundërshtuar konstatimin e Komisionit, duke parashtruar ndër të tjera se për derdhjen në shumën 101.000 lekë, në datën 11.1.2006 janë investuar kolegë të saj në marrëdhënie shoqërore në ambientet e punës, sikurse mund të ndodhte herë pas herë me qëllim shlyerjen e kësteve të kredive pa kamatëvonesa dhe në kohë, veprime këto të kryera në mënyrë reciproke mes kolegësh.

Subjekti ka sqaruar se këto hua merreshin midis shoqërisë, prej një ose më shumë personave dhe afatet e tyre ishin deri në datat e kalimit të pagës së radhës, apo të 2-3 pagave pasardhëse dhe në rastin më të parë të mundshëm shlyheshin me korrektesën shoqërore, duke rezultuar në fund të periudhave vjetore të shlyera dhe pa hua individuale.

Arsyetimi ligjor dhe analiza e provave në raport me faktet dhe me ligjin e zbatueshëm

Trupi gjykues vlerëson shpjegimet e subjektit nga ku duket se nga njëra anë parashtron rrethana reale, por nga ana tjetër nuk depozitoi ndonjë dokumentacion justifikues që të mbështesë deklaratimet e saj, si transaksion bankar të kryer prej saj në formë huadhënie me qëllim shlyerje kredie, apo një tjetër qëllim, në favor të një kolegu apo kolegeje.

⁶⁹ Referojuni dokumentacionit të përcjellë nga “Alpha Bank” me *e-mail* në datën 12.2.2020, në dosjen e Komisionit.

⁷⁰ Bazuar në nenin 52, të ligjit nr. 84/2016 dhe paragrafit 3 dhe 5, të nenit D, të Aneksit të Kushtetutës.

- ✓ Në këto kushte, trupi gjykues vlerëson se subjekti nuk provoi me dokumentacion justifikues burimin e ligjshëm të krijimit të shumës 101.000 lekë.

VLERËSIMI TËRËSOR I ÇËSHTJES

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, pasi u njoh me rrethanat e çështjes, bazuar në provat e administruara, në raportin dhe në rekomandimet e relatorit të çështjes, dëgjoi subjektin e rivlerësimit në seancë dëgjimore publike, si dhe mori në shqyrtim të gjitha pretendimet dhe provat e parashtruara nga subjekti i rivlerësimit, çmon se:

- Lidhur me kontrollin e pasurisë nën hetimin administrativ, subjekti i rivlerësimit:

- Për pasurinë e renditur me nr. 1:

i) ka kryer deklarin të pasaktë të kësteve të paguara në vitet përkatëse dhe për rrjedhojë të vlerës reale të çmimit të paguar për këtë pasuri, në kundërshtim me parashikimin e germës “a”, të pikës 5, të nenit 33, të ligjit nr. 84/2016, si dhe subjekti nuk shpjegoi bindshëm vlerën e paguar për këtë pasuri sipas nenit “D” të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë;

ii) nuk arriti të provojë destinacionin e kredisë së përfituar në shumën 2.500.000 lekë në “Alpha Bank” dhe për pasojë, nuk arriti të shpjegojë bindshëm njërin prej burimeve të kësaj pasurie (deklaruar me këtë kredi), në kundërshtim me pikën 3, të nenit D, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; bazuar në pikën 3, të nenit D, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë;

iii) nuk arriti të shpjegojë bindshëm burimin e ligjshëm të krijimit të shumës 1.200.000 lekë, deklaruar si hua e marrë shtetases G. N. dhe, për pasojë, kjo shumë nuk u përfshi në analizën financiare të vitit 2010;

iv) për vitin 2010 gjendet në balancë negative në shumën 1.593.639 lekë;

v) mospërputhjet e deklarin të subjektit se *në lidhje me të ardhurat e realizuara nga shitja e librave nuk ka fatura, pasi këto libra janë shitur në librari të ndryshme dhe në sasi të ndryshme* me veprimin e kryer gjatë hetimit, ku depozitoi 25 mandatpagesa, ndikojnë në vlerësimin etik të subjektit të rivlerësimit.

- Për pasurinë e renditur me nr. 2, veprimet juridike të kryera nga subjekti i rivlerësimit në funksion të përfitimit të një kredie me kushte lehtësuese për të financuar blerjen e një banese tjetër në Tiranë, që, nga hetimi administrativ subjekti rezulton t’i ketë në pronësi të tij, janë kryer në tejkallim të parashikimeve ligjore mbi përfitimin e kredisë.

- Për çështjet e renditura me nr. 8, dhe 9, subjekti nuk provoi me dokumentacion justifikues balancën negative, konfirmuar në arsyetimet më sipër.

Lidhur me kriterin e pasurisë, trupi gjykues çmon se subjekti i rivlerësimit nuk ka arritur nivel të besueshëm dhe ka kryer deklarin të pamjaftueshëm në vlerësimin e pasurisë, si dhe arrin në konkluzionin se ka cënuar besimin e publikut të sistemi i drejtësisë, duke bërë kështu të aplikueshme kërkesat e pikës 5, të nenit 61, të ligjit nr. 84/2016.

PËR KËTO ARSYE,

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, pasi u mblodh në dhomë këshillimi, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, sipas parashikimit të pikës 5, të nenit 55, të ligjit nr. 84/2016, bazuar në pikën 3, të nenit 61, pikën 5 të nenit 61, germën “c”, pikën 1, të nenit 58, të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, dhe në pikën 3, të nenit D, të Aneksit të Kushtetutës,

VENDOSI:

1. Shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit, znj. Bernina Kondi, me detyrë gjyqtare në Gjykatën Administrative të Apelit Tiranë.
2. Vendimi, i arsyetuar me shkrim, u njoftohet subjektit të rivlerësimit, Komisionerit Publik dhe vëzhguesve ndërkombëtarë brenda 30 ditëve pas përfundimit të seancës dëgjimore dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, në përputhje me pikën 7, të nenit 55, të ligjit nr. 84/2016.
3. Ky vendim ankimohet në Kolegjin e Posaçëm të Apelimit nga subjektet e interesuara brenda 15 ditëve nga data e njoftimit të vendimit të Komisionit.
4. Ankimi depozitohet në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit.

Ky vendim u shpall në Tiranë, në datën 15.6.2020.

KOMISIONI I PAVARUR I KUALIFIKIMIT

Xhensila PINE
Kryesuese

Brunilda BEKTESHI
Relatore

Olsi KOMICI
Anëtar

Sekretare gjyqësore
Denisa Kosta